

INTERVISTË ME MERIMAN BRAHËN

Prishtinë | Data: 21 prill, 2022

Kohëzgjatja: 249 minuta

Të pranishëm:

1. Meriman Braha (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Nëse mundeni me u prezantu? Datën e lindjes edhe diçka për historinë e familjes juaj fillimisht?

Meriman Braha: Unë jam Meriman Braha. I biri i Jakupit dhe i Halimës. I lindur me 27 të nantit të vitit 1946 në Prizren, në një familje e njohur për tradita patriotike, po për tradita të shumta, afatgjata të mundit për të krijuar lidhjen kulturore dhe shkrimore mrena familjes, për të krijuar... unë jam i dymdheti anëtarë i familjes të nanës e të babës. Dymdhetë fmi i kanë ba. Unë jam i fundit, i dymdheti. Po e baj emrin e vllaut tim të parë i cili osht' dëshmor i Luftës Nacional Çlirimtare dhe njeri që ka mbaru shkollën në gjimnazin e Shkodrës, para luftës në Shkodër. Dhe në kohë të luftës pastaj ka qenë i angazhum në Prizren, në Kukës edhe në vise tjera në Luftën Nacional Çlirimtare për çlirimin nga fashizmi. Ajo ka qenë dhe disa herë osht' burgosë. Në fund ka ra dëshmor.

Dëshmor ka ra edhe motra ime që ka qenë binake me vllaun e dytë, ata kanë qenë bineq. Të dytë janë të lindun në '28-tshin. Po kanë pasë fatin që njëni të jetoj deri vonë, tjetri të vritet në vitin '44. Tjetra, në vitin '45, '44, në fillim, janar të '44-tës osht' aprovuar Rezoluta e Bujanit në të cilën është shprehur vullneti dhe vendosshmëria e popullit shqiptar që me armë në dorë të fitoj të drejtën e vet për vetëpërcaktim, vetëvendosje me të drejtën e patjetërsueshme për t'ju bashkuar njëherë e mirë andrrës së vjetër, trungut të përbashkët shqiptar në një shtet që quhet Shqipni. Kjo ka qenë motivi i luftës antifashiste, domethonë të shqiptarëve që me të drejtën e vetëvendosjes me zgjidhë problemin e popullit shqiptar që ka mbetë për... i përgjysmumë, i ndamë nga trungu i vet.

Por, ky osht' vendim i njerëzve që kanë pasë armët në dorë në kohë lufte dhe premtimi i atyre, i Serbisë dhe të tjerëve që kanë qenë shqiptartë, fiton të drejtën e vetë për vetëvendosje nëse i bashkohen Luftës Nacional Çlirimtare. E Lufta Nacional Çlirimtare me premtime të cilat janë dhënë gjatë asaj nuk ka mujtë se si të mos reflektohet edhe tek ata të cilët kanë qenë me ide të asaj kohe të majta. Dhe kjo kategori e njerëzve të luftës, qoftë knej qoftë anej, ka qenë që do të zgjidhet problemi i, problemi kombëtar shqiptar me anë të luftës antifashiste. Por, ndodhë e kundërta.

Në vitin '45, në korrik të vitit '45 në Prizren mbahet Këshilli Popullor, mbledhja e Këshillit Popullor me delegat të ndryshëm të Kosovës, me të cilët në vend të bashkimit me Shqipëri, Kosova mbetet nën robëri sllave, serbe, përkatësisht Jugosllavisë së Titos. A ishte e drejtë kjo? Sigurisht nuk ishte e drejtë, sigurisht e drejta u shkel, u nëpërkëmbë nga ata që ishin ma të fortë se na, që kishin ma shumë miq se na, që dishin me premtu në ditë të vështirë premtime të cilat do t'i shkelnin në ditë të tjera të lirisë. Dhe në vend të lirisë, në vend të lirisë në Kosovë kemi ardhë te ni robëri të re. Robërie të Jugosllavisë Titiste që është qujtë demokratike, e në fakt, nën petkun demokratik ka bo shkelje të shumta. Jo vetëm ndaj popullit tonë, po edhe ndaj popujve të tjerë mrena Jugosllavisë. Dhe jeta e kësaj Jugosllavie u pa se përfundoi me zhbërjen e saj, sepse ishte e ndërtuar mbi parime të padrejta.

Familja ime ka qenë kundër mbetjes nën robërinë sllave. Një vlla i imi ka qenë në shkollë, i dyti, qiky binaku, Shaban e ka emrin, ai ka qenë në shkollë në Shkollë Normale të Gjakovës. Dhe në vitin '48 kur prishet Jugosllavia me Bashkimin Sovjetik, ai me shokë të tij largohen, ikin. Mundohen diçka me kundërshtu, do asi, organizohen, hetohen dhe i ikin burgut eventual në Shqipëri. Kjo ka qenë, ky ka qenë si vetë motiv i organeve të shtetit që ka pasë atëherë 20 vjet ai për me na burgosë neve si tërë familje dhe me na internu në Vojvodinë si familje e cila osht' kundërshtare e Jugosllavisë.

Nuk ka qenë e lehtë në ato kohë të vështira, në dimër, acar të burgosen babë e nanë edhe pesë fëmijë që ma i madhi është 16 vjeç ma i vogli është dy vjeç. Unë jam dy vjeç, e [për] shka, pa bërë asgjë pa pasë mundësi për të bërë. Edhe m'u internue në Vojvodinë që është një 400-500 kilometra prej ktuhit. Në një kamp internimesh në të cilin janë, do të vijnë, do të bashkohen edhe katër familje tjera shqiptare. Këto janë familja Tota nga Gjonaj, dhetë anëtarëshe me fmi të vegjël. Krejt kanë qenë fmi, një numër i madh, përveç prindërve e gjyshërve të tjetër kanë qenë fmi. Familja Shatri nga Tomoci i anës së Istogut, familja Morina nga Peja, kjo ka qenë katër-antarëshe. Familja Trasha nga Peja që ka qenë dy-anëtarëshe, nanë e bijë sepse iu ka ikë vllau në Shqipëri, djali në Shqipëri. Të gjithë kta kanë pasur dikë të ikur nga familja në Shqipni.

Dhe nuk osht'... gjatë kohës të luftës tregonte baba, nana e të tjerë sepse lufta ma nuk ka zgjatë ni ditë, ka zgjatë katër vjet. Premtimet gjatë kohës të luftës kanë qenë se, "Lum kush do të duroj, sepse me lugë floriri do të haj". Kjo është mirëqenie sociale e përsëritur dhe shpesh herë e përsëritur. Por, në këtë sistem të ri i cili po vjen nuk do t'përgjigjet djali për babën e baba për djalin. E kundërta ndodhë. Nuk do të përgjigjet kërkush për kërkënd, secili do t'përgjigjet për punën e vet. Por, ndodhë të përgjigjet jo baba, vetëm baba për djalin po t'përgjigjet e tërë familja për veprimin e djalit.

Unë me dy vjet e mija që kam mujtë me u përgjegjë për veprimet e vllaut që i ka pasë 20 vjet? Edhe ai i ri, po ideali. Të gjitha idealistat e asaj kohe kanë përfundu keq, kanë përfundu keq për arsye se armiku e ka bo punën e vet. Armiku hyn Serbia dhe Jugosllavia...

Anita Susuri: Deshta me ju pytë diçka, a ka qenë e zakonshme kjo me dërgu familje nëpër kampe apo ka ndodhë veç me familjen e ju?

Meriman Braha: Jo, ka qenë, ka pasë edhe të tjera në kampe dhe tash osht', tash vjen historia e asaj udhëtimi se osht' ni travajë e vërtetë, një mund i jashtëzakonshëm i krejt njerëzve të cilët... ne kemi shku nëpër acarë. Me 15 janar na kanë çuar në, niherë me kamion deri në stacion të trenit dikund në Fushë Kosovë, pastaj në vagonin e kafshëve kanë fut familjen tonë dhe na kanë çu atje. Ka shku e ngrime faktikisht familja jonë, të gjithë. Dhe na, gjendja jonë, domethonë e të gjithë anëtarëve të familjes ka qenë e përkeqësime tejmase. Po e keqësime prej të ftoftit shumë, s'ka pasë nxemje, ma e kafshëve. Dhe kur kemi mbërri në Beograd na kanë çu menjëherë, na kanë çu në burg, në burgun e Paçevës për me i pru n'veti se janë ngri, gjysë të ngrimë. Ka pasë hipotermi. Ju ka ra, domethonë të gjithëve, nanës, babës dhe fmi. Unë çka kam ditë, nuk mbaj mend, nuk mbaj mend gja prej asaj kohe.

Veçse tregimi i prindërve osht' kjo që neve na kanë mbyllë njëherë. Osht' rikuperu dy-tri javë, a sa ka zgjatë ajo. Mandej prej burgut të Paçevës na kanë çu në Kovilovo që osht' ni fshat nja 20 e kusur kilometra prej Beogradit. Por, Vojvodina osht' vend i rrafshët dhe shumë pjellor. Në fshatrat e Vojvodinës ka një ndërtim alla përendimor, për arsye se pjesa e mirë e popullatës ka qenë gjermane, popullatës vendore, Vojvodinës gjermane, hungareze dhe serbe. Gjermanët kanë qenë në numër ma të madh, hungarezët, pastaj kanë ardhë serbët. Edhe na çojnë në këtë fshat.

Ky fshat ka qenë pak i përzimë dhe ka shërby që në vend të fshatit të bohet kamp. Fshati si kamp. Interimet e tilla na i kemi pa aty, për arsye se kur na kanë çu neve në internim kemi has në ni numër shumë të madh të grave gjermane, hungareze, po numër ma të madh të gjermanëve. Burrat e të cilëve ose djemtë e të cilave i kishin pushkatu fashistat pa analiza dhe gjykime. Diku nja, në, gjatë kohës së hulumtimit tim për të shkru ni vepër për Goli Otokun, ni vepër publicistike që ka nja 300-400 faqe, kam has në të dhana të sigurta se kanë pushkatu shumë të burgosur, kanë pushkatu shumë gjermanë në emër të fashizmit. Nja 50-60 mijë veta, ndoshta ma shumë, i kanë lidh dhe i kanë çu në Bashkimin Sovjetik.

Nja 50 mijë ose njëqind mijë njerëz nuk e di sa tamon sepse nuk osht' kthy kush prej atjehit. I kanë çu dhuratë Stalinit, i kanë çu dhuratë Bashkimit Sovjetik për humbjet që i kanë pasë prej gjermanëve, se kanë pasë shumë humbje Bashkimi Sovjetik në luftë. I kanë çu ata dhe ata i kanë çu në miniera të Siberisë prej kah ata s'janë kthye kurrë ma. Ku kanë përfundu, çfarë miniere, nuk e di. Por, janë, disa janë komisione, komisione shtetërore në Slloveni, Kroaci, Bosnje nuk osht' shumë aktiv edhe në Serbi. Komision shtetëror, komision shtetëror që merren me hulumtimin e varrezave masive të njerëzve të pushkatum pa gjyq. Dhe në mesin e tyre ata kanë zbulu dikund afër, afër 40-50 mijë njerëz gjermanë të pushkatum.

Tash, familjet e gjermanëve të pushkatun ose që s'kanë mrri me i pushkatu gra e fmi i kanë marrë i kanë çu në disa qendra, disa. Në këtë qendrën e internimeve ku kemi shku na, ku na kanë çu neve kanë qenë me mijëra, një mijë, a dy mijë, a tre mijë gra dhe kanë qenë në punë të detyrueshme të punëve

bujqësore, sepse aty kanë ngritë... Ky kamp i internimit ka pasë për detyrë me punu fushat në numër me qindra hektarë që i kanë marrë pronat e gjermanëve, i kanë asi [nacionalizu]... dhe ia kanë lëshu. I kanë futë në kombinatë të ndryshme, i kanë çu në kooperativa të ndryshme, dhe ato kanë prodhu prodhime të ndryshme bujqësore e blegtorale dhe me to i kanë furnizë Beogradin. Krejt puna e tyre ka qenë me hangër bukë edhe me punu arën...

Anita Susuri: Si skllëvër.

Meriman Braha: Si skllëvër. E edhe baba im ka punu qishtu, domethonë baba dhe vllau im Qemali që ka qenë 16 vjeç atëherë. Ai ka qenë një prej nxansve ma të mirë të gjimnazit në Prizren edhe iu prish jeta, komplet iu çrregullu, komplet. E pasurinë e gjermanëve e ka konfiskue shteti, pasurinë. Tokat, arat, shpijat krejt janë konfisku prej shtetit dhe kurrë kurgja s'osht' pagu për ta deri në ditën e sotshme. Ajo osht' pronë të cilën shteti e ka uzurpue në emër të luftës kundër fashizmit e nazizmit gjerman. Të gjithë, afër një milion gjermanë nga Jugosllavia janë shpërngulë dhunshëm për në Gjermani dhe në Austri.

Edhe pse kanë kundërshtu niherë fillimisht perëndimi e ku ta di, por me kohë i ka çu krejt, krejt. Dhe sot mund të jetë një mijë ose dy mijë vetë. Nuk e di a ka në krejt Vojvodinën që shtrihen në Serbi dhe në pjesë në Kroaci. Në pjesë, Vojvodina osht' në pjesë që shtrihet prej Kroacie pjesën tjetër të veriut të Serbisë deri në kufi me Rumaninë dhe Hungarinë. Prandaj, baza e autonomisë së asaj osht' etnike. Përbamja etnike gjermanë, hungarezë, pastaj sllavë. Dhe nuk ka asgjë historike, kurrë s'ka qenë pjesë e Serbisë kjo.

Ky numër i madh, enorm i madh i grave dhe vajzave gjermane, hungareze, pak shqiptarë, katër-pesë familje shqiptare, kanë qenë të vendosuna nëpër baraka. E barakat kanë qenë për të internuarit. Por përveç barakave janë përdorë edhe shtëpitë e braktisuna të gjermanëve. Dhe kta të internuarit kanë jetu edhe nëpër shtëpi. Por, s'kanë pasë të drejtë me dalë jashtë kooperativës së kombinatit të tyre që ka pasë me mijëra hektarë tokë që i kanë punu. Kanë prodhu të mira materiale bujqësore, grunë, domethonë drithëra, kanë prodhu vaj të lulediellit e panxharsheqeri me shumicë, me mijëra, me qindra hektarë. Kanë lavru edhe e kanë pasë në kombinat të madh.

Me dhjeta kanë qenë shtalla dhe ato shtalla kanë qenë shtalla me lopë, me vjeta, domethonë viqa të ndryshëm për mish, me pula, rosa, pata, çka s'ka pasë. Domethonë, të gjitha ato janë nën kujdesin e organizum të shtetit, po punën fizike e kanë bo njerëzit që kanë qenë të internum. Domethonë, përveç gjermanëve dhe katër-pesë familje shqiptare që i përmenda pak më parë.

Anita Susuri: Po a kanë pasë ata ndonjë përqindje apo kurgjo?

Meriman Braha: Nuk kanë marrë ata...

Anita Susuri: Qysh janë ushqy për shembull?

Meriman Braha: Ushqimi ka qenë kolektiv. Kanë ngritë atje edhe familjet tona, niherë janë ushqy me ushqim kolektiv që kanë pasë një menzë. E kanë ndërtu ata, pse a po është problem me ndërtu një shtet një menzë? Edhe hyn merre gjellën, haje, e dil e puno. Kaq ka qenë. Jashtë atij [kampi të punës] me leje, jashtë atij vendi munësh me dalë me leje, me ta dhanë leje dikush prej përgjegjësve. Dhe baba im u dashtë me marrë leje për me shku në Beograd me u anku, për arsye se vendosja dhe pjesa... familja osht' internu pa vendime gjyqësore. Asnjë dokument nuk e ka pasë kërkush. As baba im, as familjet tjera.

Kjo osht' ni lloj kidnapimi, ni lloj marrje peng e familjes edhe çoje ku të dush, lidhe edhe çoje ku të dush. Dhe vitin e parë, domethonë kur na kanë vendosë vitin e parë na kanë vendosë në shtallën e lopëve. I kanë hjekë dy lopë, nuk e di ku i kanë çu ato. Vendin e tyne e kanë përshtatë për me fjetë familje Braha, familje Tota, jo familje Tota ka qenë me ni tjetër barakë, po ashtu me lopë. Barakën tjetër familja Shatri, familja Braha, familja Morina dhe Trasha kanë jetu në 25 metra katrorë.

Anita Susuri: Të gjithë së bashku?

Meriman Braha: Të gjithë së bashku. Aty kanë fjetë, aty i kanë pasë jetën e tyne. Dimrin e parë as zjarrim s'e kanë leju m'u ndezë, m'u nxehtë, m'u ngrohë fmitë, fmitë e të mdhajt. Dhe kur janë anku kta, "Na keni futë, po ngrihemi, ftoftë, dimër", thotë, përgjegjësit e kampit, thotë, "Nëse s'ngrihen loptë nuk ngriheni as ju. N'u ngrifshi punë e madhe. Çka na kushton? Ni armik ma pak". Edhe kështu ka kalu dimri. Janë ushqy atje në menzë, por fjetjen, qëndrimin ditor e kanë pasë aty bre në mesin e lopëve, në avullin e lopëve. Janë nxe me avullin e lopëve. Nga të ftoftit të gjithëve ju kanë ajë dur të e kam të dhe osht' paraqitë morthi, nifare sëmundje e kërrhamzës apo do zhuga me iu ra, të gjitha këto. Vendi i papastërt.

Me lopë, lopë, të cilat domethonë janë disa, disa shtalla lopësh janë marrë gratë gjermane, ato i kanë mjelë dhe kantat me qumështin e lopëve i kanë mbledhë i kanë çu në Beograd me ia dhanë për qytetarë, me i shitë a me i asi... e gjermanët kanë qenë ato të cilat në njëfarë mënyre kto familje me halle shumë, se ato kanë jetu jo në shtalla të kafshëve por në baraka kur kanë qenë të tërë popullume. Barakat të ngarkume shumë. I kanë pasë nga dy shtretër një për mi një dhe kanë jetu aty. I kanë improvizu barakat i kanë ndërtuar me të shpejtë, me punën hangari, me punën të ktyne vetë të internuarve.

Pastaj, tash ato nuk janë ma moti janë asi... po atëherë ka qenë kështu. Në mes tjerash, gjermanët i thonë edhe nanës time, "Merri dur të djalit për me ia... se neve vetë na ngrihen dur të prej së ftofti dhe kur shkojmë me i mjel loptë i nxehtë, i ngrohim me gjirin e lopëve dur të tona, për m'i liru pak gishtat për me mujt me e bo mjeljen e tyne. Prandaj shfrytëzoj momentet që edhe djalin e vogël", se djali i vogël. Po unë kam qenë ma i vogli aty, por s'jam ma i vogli. Sepse në kohë të, në përfundim aty, nuk e

di, në përfundim të dimrit lind një fmi në e atë vend. Është lindë fmija familjes Morina të Pejës, që nusja... që osht' nuse faktikisht ka ardhë shtatzanë. E kanë pru shtatzanë nëpër atë dimër, nëpër atë kijamet në asi... dhe i ka lindë në shtallën e lopëve ka lindë një vajzë.

Ajo vajzë sot është 70 e kusur vjeç. Jeton. Ka punu në Kuvend të Kosovës, Advi e ka emrin, Advije Morina. Edhe domethonë, nana ime ka qenë pritëse e lindjes të saj, ka qenë mami. Eh, mami e zorit se edhe përvoja që ka pasë me lindjen e fmive të vet, por edhe e momentit kur u dashtë me i dalë në ndihmë asaj nuses së re që... lindja, pra lindja kur, baba i vajzës, Shaniu, Shani Morina, ankohet në asi dhe kërkon që ta çojë, t'ia çojë nusen në spital që të lindë në spital që të lindë. Thonë, "S'kemi mundësi, nuk punon telefoni, nuk punon kjo... le të lindë qashtu qysh kanë lindë nanat tona". Edhe e ka lindë vajzën.

Mas një dite, dy, lopa tjetër ka pjellë, por s'ka pjellë vetëm. Kanë ardhë veterinerët prej Beogradit për me pjellë lopa, por jo për me lindë grua, jo për me lindë grua. Që me thanë është një mori senesh absurde të cilat nuk mund t'i kap mendja e njeriut t'i kap në mënyrë normale. Ato i bëjnë qëllimisht sepse je etiketu si armik që në fakt nuk, nuk është e pavërtetë. Është e vërtetë që jam armik i atij i t'cilit, i cili të okupon, të mban në robëri dhe të imponon një jetë robërie të rëndë. Une e kam, i kam botu nja tri vepra. Nji asht' për këtë punë e titullohet "Vorbullat", për punën e jetës në asi dhe është mirë për interesin tuaj që ta lexoni edhe aty përshkruan gjana të vërteta që kanë ndodhë. Emrat janë ndryshu por është, e vërteta është aty. Asgja përveç shkrimit që merr kuptimin artistik.

Asgja nuk është e trillune, çdo gja është e vërtetume. Dhe në ato kushte, domethonë me kushtet e randa të jetës së vështirë në Vojvodinë i kalunë tri vjet familja ime. Mbas tri vjetësh bijnë nifare vendimi për m'u kthy në Kosovë, por nuk na kthejnë neve në Prizren në shtëpinë tonë. Na mbajnë afër ni fshati, afër është ni fshat që quhet Miradi, fshati quhet Miradi, Dobrevë i thojnë serbisht, Dobrevë. Miradi i thonë shqip. Dhe kemi kalu aty ni vit tjetër, familja ime. Kjo është pjesë e veçantë e ndame prej ktyne familjeve tjera, pse ato kthehen nëpër shtëpitë e tyre në Pejë, Prizren e ku ta di, e në atë Tomoc të Istogut.

Ndërsa ne e kalojmë ni vit në asi [Miradi]... dhe mas ni viti të kalimit të jetës të kooperativës bujqësore si familje e vetme e internume tash në kooperativë, që ishte tashti ni rrethanë tjetër. Nja tri vjet mbas internimit në Vojvodinë, vazhdon internimi i familjes time, po tashti e vetmume. Në mesin e... në një kooperativë bujqësore, familja e internume, por në kooperativë bujqësore. Edhe punojnë fizikisht, punojnë tokën deri në kthimin tonë mrena atyre, kthimin tonë në Prizren.

Pjesa e Dytë

Meriman Braha: Gjatë kohës së, sa kemi qenë të internum kanë qenë të konfiskume pasuritë tona, të babës edhe shtëpia edhe toka edhe... na faktikisht kemi jetu si të burgosur. Kemi punu për me jetu. E vetmja, i vetmi shpërblim ka qenë shpërblimi yt me jetu, me mbijetu dhe me mbajtë shpirtin gjallë.

Fëmijët i kanë pasë të ndërpreme shkollimin. Vllau i madh, Qemali, e ka ndërpre shkollimin në gjimnaz. Seradini, vllau i dytë, po ashtu ka ndërpre shkollimin tetë-vjeçare, Alija e ka ndërpre shkollimin tetë-vjeçare, ka qenë në klasën e tretë ose të katërt edhe Limanja që jeton në Gjakovë tash, punon, e ka ndërpre klasën e parë. Klasën e parë filllore, gjysëm vjetortë e klasës të parë.

Tek mbas tri vjetësh fillon përsëri me marrë frymë, sepse ktu na lejojnë dhe fmive ju lejojnë shkollimin. E prindërit kanë bo punë fizike si të tjetër, antartë e tjerë të kooperativës deri në kthimin tonë. Në kthimin tonë iu kemi kthy tokës. Na kanë kthy ni pjesë të tokës, ni pjesë e kanë konfisku në mënyrë të përhershme dhe shtëpinë që e kemi gjetë bosh e kemi lonë plot. Po nuk kemi gjetë as grunë, as kollomoq, asni send. E kemi nisë jetën prej fillimit në asi... jetën prej fillimit në shtëpinë tonë të vjetër. Kjo osht' ni pjesë.

Kjo ka të bëjë deri në vitin '53 kur përfundon puna e internimit. Por nuk përfundojnë problemet e familjes dhe s'përfundojnë problemet e ballafaqimit me okupatorin tonë, sepse të tjetër rriten dhe fmitë që rriten nuk mund të jenë ata që harrojnë të kalumën tu dëgju prej nanës, babës, vllaut, motrës, njani-tjetrit. Tu e pa gjendjen e vërtetë dhe tu kundërshtu pjesën e tutjetshme të robërisë sllave. Në ndërkohë prapë burgoset baba aty sa kthehemi në Prizren...

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë arsye apo...

Meriman Braha: E kanë burgosë pa arsye. Arsye është vllai im i mbetur në, i ikur në Shqipni. Babën e kanë burgosë, po e kanë burgosë edhe vllaun, Qemalin. I kanë majtë gati ni vit pa letër, pa vendime gjyqësore. Hetime të kohshme dhe presione të ndryshme për t'i thye, për t'i ba argat të shtetit në kundërshtim me dëshirën që e kanë, me dashninë që kanë për vendin. Mandej, e konfiskojnë shtëpinë tonë, e qesin familjen prej shtëpisë, po tokën e lanë, tokën e lanë. Dhe baba ka qenë punëtor i mirë, osht' pjesëmarrës i luftës të vet, i Luftës së Dytë Botërore bashkë me djalin domethonë. Nuk e ka... po ideja ka qenë që duhet të bashkohemi me Shqipninë dhe në mënyrë të vazhdoj jeta, të vazhdohet jeta në mënyrë normale, por normalitet nuk ka pasë.

Normalitet nuk ka pasë as ato vite, domethonë të kthimit tonë në Prizren as ma vonë në vitet e... na jemi rritë kur unë kam kry shkollën, gjimnazin e kam kry, kur e kam kry Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren, kur e kam kry fakultetin në Prishtinë e të tjera. Dhe vllaznit e tjerë e motrat e tjera po ashtu kanë, janë angazhu në msusi. Ndërsa vllau i madh në ekonomi ka kry shkollën e mesme ekonomike me privat, me sistemin privat të shkollimit, deri në vitin '68. Në fakt, viti '68 është vit i shënum me demonstratat edhe me lëvizjen masive studentore. Po përpara vitit '68 është ramja e Rankoviqit.

Ramja e Rankoviqit osht' ni përplasje e dy rrymave në Jugosllavi. Ni përplasje e rrymës hegjemonisë serbomadhe më unitariste, domethonë të gjitha në qendër me rrymën pak a shumë decentraliste, decentralizuese, perëndimore të, që ishim bartës në Kroaci dhe në Slloveni. Dhe ramja e... përplasja e ktyne dy grupeve u shënu me ramjen e Rankoviqit. Rankoviqi osht' sinonim i unitarizmit serb,

centralizmit të madh shtetëror dhe një, të një Serbie të Madhe të pshtjellun me petkun e Jugosllavisë. A në fakt ushtria, policia, gjygi që janë leva kryesore të shtetit dhe ekonomia dhe janë të shtetit kanë qenë në duar të serbëve. Domethonë, popujt e tjerë kanë qenë fasadë.

Në këtë fasadë, pjesa jonë është pjesa e shqiptarëve e cila vazhdon burgosjet e shumta, vazhdon qëndresën e vet me burgosje të shumta. Çdo vit burgosen me qindra shqiptarë me të drejtë, me kërkesën e të gjithëve, të të gjithave grupimeve politike ilegale kundër-jugosllave. Të gjitha në sens kanë qenë kundër Jugosllavisë dhe [për] bashkimin me Shqipërinë, të drejtën e vetëvendosjes të popullit shqiptarë. Por nuk u realizu kurgjo. Deri në vitin '68, kur unë si student, kam qenë student i Shkollës së Lartë Pedagogjike, pastaj i fakultetit në Prishtinë. Në Prizren njëherë Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe aty kemi pasë njëfarë, kanë pasë një shoqëri të gjerë, të madhe të studentëve, të rinisë shkollore të asaj kohe.

Klima politike ishte ndrru. Gjykohej Plenumi katërt, gjykohej UDB-a që kishte përdorë shumë dhunë, që kishte përdorë shumë padrejtësi, kishte bo shkelje të shumta. Në mes tjerash edhe ndër shqiptarë dhe veçanërisht në shqiptarë. Unë e mbaj mend në atë kohë kur shqiptarët torturoheshin për ni grusht miell, kur hishin përmbaruesit shtetëror nëpër shtëpia për me ia fshi miellin prej magjeve. Osh' koha e *otkupit*¹ quhej, që është *ujemi*², është një planifikim shtetëror se ti ke kaq tokë, ke kaq miell, do të prodhojsh kaq grunë dhe do t'ia japësh shtetit kaq *ujem*. Kaq të takon me dhanë ty pjesën e të mirave materiale. Pjesa e të mirave materiale janë prej të gjitha prodhimeve bujqësore, qoftë edhe blegtorale. Domethon, edhe në tlynë edhe në vaj, çdo gja duhesh me dhanë ti pjesën tane për me forcu shtetin.

Shteti ka pasë kriza në atë kohë se s'ka pasë boll prodhime të veta, s'ka pasë. Dhe ka dështu kooperativa, ka dështu kolektivizimi, kanë dështu shumë gjana të cilat e detyrojnë shtetin të kthehet prapë në privatizim të gjanave të cilat, tash private, duhet të kompenzoj ato që i duhen shtetit. Pra, e në atë kohë lindin dy probleme të mëdha për shqiptarët. Edhe kjo e përqindjes dhe *otkup-it* dhe trysnisë së madhe politike, ekonomike, fizike për shpërngulje të shqiptarëve në Turqi. Jo në Shqipëri, por për shpërngulje të shqiptarëve në Turqi. Çdokund është pyetë, "Pse në Turqi? Pse shqiptarët në Turqi?" Për arsye se nëse kta shqiptarë do të shpërnguleheshin në Shqipëri, do të forcohej Shqipëria. Ashtu i shpërngulin kta shqiptarë në Turqi, në ni vend që osht' larg prej Serbisë dhe me ia hup identitetin.

Ktu ka pasë ni hile të hershme që është bashkë me Jugosllavinë që osht' Turqia e lidhun dhe osht' marrëveshja e vitit 1937 e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Shqipëtarët në Turqi janë shpërngulur nën presion të shtetit me motivacion se janë myslimanë, dhe si të tillë vendin e kanë atje në Turqi sepse ky vend është i krishterë dhe i Serbisë. Në fakt nuk osht' kështu, shqiptarët janë shqiptarë,

¹ Serb.: *otkup*, dorëzimi i detyrueshëm shtetit të prodhimeve bujqësore sipas procedurave administrative të rregulluara me ligj.

² Mielli ose drithi, që i jepej mullisit si pagesë për blojën; prodhimi që jepej si pagesë për një punë që bëhej në bujqësi.

myslimanë ose të krishterë. Por kombësinë nuk e tëhuajësojnë në emër të fesë dhe me identifikim të fesë, identifikim të kombit me fe.

Por, viti '56-'57 është i mbushur me tortura të shumta të gjithanshme në popullatë. Unë e mbaj mend shumë mirë vitin '56, kam qenë nxënës i klasës së tretë më duket, fillore dhe kur merreshin burrat në pyetje me çka, në filan, prej UDB-së dhe atje torturoheshin mizorisht për të dorëzuar pushkën, për të dorëzuar armën. Ndoshta që s'e kishin. Ni numër i madh i tyre që s'e kishin. Për me mujtë me dorëzuar armën e kanë bo ni kanal të veçantë të shitjes gjoja, të shitjes së armëve dhe njerëzit detyroheshin me ble armë dhe me ia dorëzuar, "Qe e gjeta dhe po ta dorëzoj". E me ia shënu prapë e njejta armë m'u kthy te tjetri, te tjetri.

Ky presion i madh ka ba që numër i madh i njerëzve të ndrojnë edhe identitetin e vet dhe të regjistrohen si turq, për me mujtë me kalu ma lehtë edhe me u shpërngulë ma lehtë. Në vitin 1953, Turqia e rifuqizon marrëveshjen e vitit 1937. Kjo marrëveshje e vitit '37 planifikon çdo vit me kah dhetë mijë familje të shpërngulen për në Turqi. Unë e mbaj mend, shtëpitë e Prizrenit, ni numër i madh i shtëpive, atëherë kemi jetu, na kanë pasë çue në ni shtëpi të një Hysen Kodrës. Dhe nuk e di a kanë pagu qira, a s'kanë pagu. Dhe i mbaj mend familjet që shpërnguleshin për në Turqi dhe s'kishin shtëpijat kujt me ia shitë. S'kishin. S'kishte blerës për shpi.

Ata i kryqëzonin shtëpitë në dy drrasa {bën me gishta kryqin}, kryq për jashta te dera e shpisë i viheshin, gozhdoheshin dy drrasa kryq *bam-bam* {onomatope} poshtë e naltë në dy antë, dy drrasat, në mes. Dhe ishte sinjal që shtëpia është pa zot, është shpija, i zoti i shpisë ka shku në Turqi, krejt familja ka shku e s'e ka ble kërkush. S'ke pasë kujt me ia shitë. Në vitin 1953 osht' fuqizu kjo në '56-tën osht' *vurmaku* [trq. goditja] i madh, domethonë, një torturë e përgjithshme masovike ndaj shqiptarëve. Një presion i papamë gjithfare, kryesisht politike por edhe ekonomike. Dhe i kanë kushtëzu, "A do ti me punu në një punë të shtetit?" "Po", "Regjistrohu si turk", "po s'e kam pasë as babë as babëgjysh", "Kush t'pyti për babën e babëgjyshin? A je musliman?" "Po", "Regjistrohu si turk".

Ka pasë shumë të burgosur politik dhe politik shumë që i kam njoftë unë në Prizren, që shtëpitë e tyre kanë folë turqisht por kanë ra politikisht në burgjet jugosllave për shkak të Kosovës për m'u bashku me Shqipninë. Dhe, "Çka po lypë ti? Te shpija flet turqisht. Pse po lypë m'u bashku me Shqipninë? Ti e ki vendin në Turqi", "Jo, unë e kam vendin në Kosovë edhe Kosova e ka vendin në Shqipni". I kanë marrë me kah 20 vjet 30 vjet burg. I kanë pushkatu me... shumë i kanë pushkatu. Mos t'flasim për grupet e pushkatimeve të cilat kanë qenë kundër atyne, po s'ka pasë forcë me përballu Jugosllavinë. Se ka qenë në krahasim me kryengritjen e popullatën shqiptare, ka qenë ku e ku ma e pregatitur për luftë sesa na.

Na s'kemi pasë as miq, është e keqja e madhe. Na s'kemi pasë miq të jashtëm, Jugosllavia në atë kohë ka pasë edhe miq perëndimorë edhe miq lindorë. Na s'kemi pasë as lindorë as perëndimorë. Kjo osht' fatkeqësia jonë deri në vitin '99. Për herë të parë në vitin '99 na del dikush për me na nimu. Në fakt...

Anita Susuri: Kto vitet që i përmendët, qysh ka qenë krejt atmosfera e jetës kur ju keni qenë fmi? Qysh nga perspektiva e juj qysh e keni pa krejt ngjarjen?

Meriman Braha: Ka qenë shumë e randë ajo. Na kemi qenë, ajo ka qenë ni jetë e randë kryesisht njerëzit mezi që e kanë lidhë jetën, mujin, mrena mujit me jetu. Ka pasë ni periudhë ka qenë koha e urisë. Ke shku argat e ke shitë trupin tand diku, ke shku argat me punu në ara veç për ni drekë, për me hangër drekë. Qikaq ka qenë randë. Për me tregu se ku ka mrri puna, unë kam qenë maturant i gjimnazit në vitin 1964-65, a e din sa maturantë kanë qenë në gjimnazin e asaj kohe? Shqiptarë? Dy klasë kanë qenë. Klasa ime ka qenë e shkencave natyrore, qishtë quhej dhe kishte 18 nxanës. 18 nxanës maturantë ni gjimnaz. Klasa tjetër ka qenë gjuhësore, njimdhetë nxanës. 29 nxanës i ka pasë gjimnazi. 29 paralele janë tash maturantë në gjimnaz.

Anita Susuri: Ju keni qenë në “Gjon Buzuku” apo?

Meriman Braha: Atëherë ka qenë, atëherë ka qenë “Jovanka Radivojeviq - Kica”, ma vonë u bo “Gjon Buzuku”. Në kohën e viteve ‘90-ta janë ndryshu emrat me paralelizmin dhe me pavarësimin e shkollës shqipe në kushte të okupimit serb. Edhe më vonë pastaj mas çlirimit ka vazhdu. Unë tash kur kemi qenë në vizitë në gjimnaz në rastin e 50 vjetorit të gjimnazit, 30 e kusur paralele janë maturantë. Atëherë 29 nxanës i ka pasë krejt Prizreni maturantë në gjimnaz. Është e jashtëzakonshme, e jashtëzakonshme. Domethonë ka qenë ni zhvillim totalitar i cili ka, nuk ka lanë gja pa ba në favor të shkatërrimit të qenësisë shqiptare, totalitar. Dhe Noel Malcolm e thotë në veprën, “Histori e shkurtë e Kosovës”, për shqiptarët, “1945-ën nuk ka qenë çlirim deri në ‘66-tën, ka qenë ni totalitarizëm *par excellence* [e më të lartës cilësi], ma totalitarizëm se në Bashkimin Sovjetik”.

Jugosllavia ka qenë, edhe pse ka pasë, Republika Demokratike Federative, nuk ka pasë demokraci fare. Jo për... vetëm plani shtetëror ka ekzitu. Domethonë ka qenë ni kohë shumë e randë, kohë shumë e randë. Dhe te shkollat që kanë qenë të hapura, unë e kam kry katër klasë ni shkollë e cila osht’ në ni shtëpi. Shtëpia e Emrush Agës, ka qenë shtëpia e Emrush Agës. Unë nuk e di kush osht’. Tash e di se një emër iu ka dhanë ni rrugë në Prizren, Emrush Aga. Emrush. Ka qenë ni shpi dy-katëshe, u konfisku dhe shteti e ka bo shkollë. Deri në klasën e tetë kam qenë në një shtëpi që është konfisku prej Mësërlive, qishtë u qujtë familja, Mësërliu dhe u bo shkollë. Kjo domethonë tregon që nuk ka pasë kujdes për shkollimin e duhur të popullit shqiptar.

Anita Susuri: E këto familje kanë qenë ndoshta si ma të pasura që ju kanë konfisku...

Meriman Braha: Po. Kanë qenë ma të pasura, kanë qenë ma të pasura dhe janë konfisku ato shtëpitë. Ka qenë edhe kjo familja e Alishanve, Njazi Alishani, “Emin Duraku” [shkolla] ku osht’ sot, pak ma knej ka qenë. Shtëpi, tre vetë janë pushkatu, Njazi Alishani me vllazën të vet në ‘45, ‘46, ‘47, ‘48, janë pushkatu për shkak të përcaktimit të tyre kundër Jugosllavisë, dhe shtëpia, familja e tyre ka qenë e

internume po ashtu në Zemun Pole afër Beogradit. Një familje tjetër, kjo është e Alishanve, familja Alishane 22 anëtarë të familjes në Zemun Pole, Vojvodinë është.

Një familja e Axhi Malokut, unë e kam pasë shok klase dhe ai është në Surçin të Beogradit. Osht' internu familja e tyne në Surçin. Dikush, ni Avni ka lindë atje. E familje tjera plot ka që kanë, janë internu mrena Kosovës, nëpër familje i kanë çu. Ti je qajtë i internumë, të kanë qit' prej shpije, të kanë çu me ni shpi të dikujt tjetër dhe të kanë kufizu lëvizjen. Domethonë, atëherë ka pasë ni ndjekje masive të çdo gjaje. Ni milion që ka mendu shqip, ata kanë ba çmos për me zhdukë fizikisht popullin shqiptar. Kjo është.

Niherë ka qenë vala e 1878-ës, 1912-ës, 1918-ës, 1945-tës, 1996, 1998 kur i kanë përzanë për Shqipni ni numër të madh të shqiptarëve. Gjysmën e kombit tonë e kanë përzanë anej, se s'kanë mujtë m'i vra krejt. Po kanë vra njerëz, gra, plaka, fmi e çka kanë gjetë për me kriju tensione të tilla që njerëzit të ikin t'i braktisin vendet e tyre. Nëse kjo e fundit mbahet mend '99-shi, ikja, mbetja, vrasja edhe varrosja masive, grupe, ato tjerat nuk dihen. Vetëm në vitin 1912 kur kanë hy në Prizren forcat sllave, serbe, gjeneral Jankoviq, ai gjeneral Jakonvq është shqiptaro prerës, vrasës i shqiptarëve, gjeneral. A e din që qyteti kufitar me Maqedonin quhet gjeneral Jankoviq? Jo, nuk e din, sepse ia kanë dhanë serbo-mdhejtë emrin. Qikjo që është kufi tash. Kufi me Maqedoni është qyteti Elez Hani është qajtë gjeneral Jankoviq. Elez Han, Hani i Elezit, gjeneral Jankonvq.

Kur ka hy në Prizren gjeneral Jankoviq me ushtartë e vet 500 vetë i ka vra mrena ni ore. Ka hi nëpër oborre, nëpër shpija s'ka rëndësi, gru a burrë a çka, fmi a, vraj sa ma shumë shqiptarë, 1912-shi. E s'ka pasë ushtria turke, nuk ka pasë rezistencë është terheqë, ka ikë pa luftue në mbrojtje të Prizrenit. I ka lshu pozitat e veta dhe kanë hy forcat serbe e kanë okupu Prizrenin. Vetëm në ortë e para janë vra 500 vetë, pa e ditë kush për çka po vriten. Po vriten veç pse janë shqiptarë. Janë gjashtë valë të zhdukjes të tentimit për gjenocid ndaj shqiptarëve. Na i kemi rezistue. E kam për detyrë me ju kallxu, mos e pritni që t'bohet vala e shtatë. Ju jeni t'ri çka s'keni me përjetu. Me qita dreqën që i kemi kojshi prapë kanë, nuk hjekin dorë me dalë përsëri në detin Adriatik, në Durrës.

Në vitin '68 klima u ndryshu dhe na, unë isha atëherë student. Nuk kishte asnjë bashkësi lokale të Prizrenit që nuk mbante mbledhje për të shfry pezmin e vet ndaj krimeve që kish bo UDB-a në atë rreth, secila bashkësi lokale kumeditë sa herë. Dhe na si të ri shkojshim për të ndëgju rrëfimet, si tash ti, ju, që doni me ndëgju prej meje rrëfimin e asaj kohe. Na shkonim me ndëgju rrëfimet e torturave që ka bo UDB-a mbi njerëzit nëpër bashkësi lokale.

Aty kush kishte guxim tash, nuk u dike a po vjen prapë UDB-a, por nëse vjen e ti i thu që UDB-së ia kemi pa sherrin e ka bo ktë e ktë, atëherë mund të përgjigjeshe përsëri. Por, megjithatë në popull ishte bo nifarë lirimi, ishte bo nifarë frymëmarrje ma e lirë dhe njerëzit fitun nifarë guximi për të thanë të vërtetën çka kishin hjekë. A kemi ndëgjue edhe qobanët, "M'kanë shku dhentë posht për shkak të

torturave që m'kanë ba mu, familjes time. M'kanë hup kaq dhen, m'kanë cofë kaq. Nuk ka pasë kush me iu qit' dhenve". Deri aty ma edhe qobanëve.

Na shkojshim për të ndëgju edhe rrëfimet e tyre të torturave të UDB-së, të presioneve të shumta çka s'ta merrke menja. Na mund të mos dishim, për shembull, që filani, dukej i urtë e sene e kështu po UDB-a e kish marrë, e kish rre, e kish shti në ujë në të ftoftë. Ajo Bistrica që duket sot pak e shterrun me pak ujë, atëherë ka pasë ujë shumë. Ka pasë aq shumë ujë sa nuk kalonte verë pa u mbytë dikush prej fmive që u lajshin në lumin e Bistricës. Në Lumin e Bistricës kanë qenë disa, shumë mullinjë për të blu me drithë. Mullinjtë, vendet e mullinjëve ato thellësitë e tyre të ujërave afër mullinjëve i kishin shërby UDB-së për t'i futë njerëzit në kohë acari me -20 gradë jashtë, aty në ujë kemi hy me tllina veshë.

Anita Susuri: E ju që po thoni, a kanë qenë si mbledhje kto apo si kanë qenë?

Meriman Braha: Kto kanë qenë mbledhje dhe kjo ishte ni, kanë qenë mbledhje dhe ishte ni...

Anita Susuri: Publike apo?

Meriman Braha: Publike, publike kanë qenë. Mbledhje publike dhe thirrreshin për të sqaru njerëzit nëse kanë ankesa për të tregu damet që iu kanë bo, kompenzimet eventuale. Po askujt s'ju ka kompenzu kurgjo. Ku ka pagu ujku për kingjin e prerë, e ka ngranë edhe shkoi. N'kofsh i zoti me vra ujkun, përndryshe vjen prapë. E tash... e kto vite, '67-'68 kanë qenë vite të shfryrjes dhe populli shfrynte. Dhe në ato vite, në mes tjerash në popull u përhap një, një bindje politike se na të lidhun me Serbinë nuk kemi kurgja, as s'duhet të kemi kurgja të lidhun duhet të ndahemi prej Serbisë.

Në këtë kohë, domethonë në masë ishte pjekë dëshira për tu nda prej Serbisë. Se Serbia nuk ka qenë krahinë autonome e Kosovës, kështu krahinë, por është qujtë *oblast*, [në përkthim] provincë. Krahinë ka qenë Vojvodina, ndërkaq Kosova ka qenë provincë. Provincë, provinca, provincë autonome dhe pikë. As, tash u ngritë, është kërku që të ndahemi prej Serbisë, është kërku në masë. Prandaj, neve të rive edhe në, po për hir të së vërtetës edhe në kuluarat politike të Kosovës filloi të përmendej zgjidhja e problemit të Kosovës me avancim të pozitës së Kosovës në Jugosllavi, federatë. Avancim të pozitës, ajo ishte provincë. Provincë ishte niveli i tretë i autonomisë. Domethonë, me suprimu, gati gati suprimim sa një komunë, sa një bashkësi e komunave, të drejta.

Pjesa e Tretë

Meriman Braha: Pra, siç thashë në ato vite pat edhe në mesin e politikanëve kishte njëfarë kërkesë që të ndryshojë pozita kushtetuese e Kosovës në Jugosllavi. Dhe është hera e parë që në mesin e gjithë u ndëgjua dhe Kosova të bëhet republikë si republikat e tjera. Kishte risi për atë kohë. Ishte risi që vinte në forma të ndryshme dhe ma vonë në lexim të asi, kam pa se ka qenë edhe para Luftës së Dytë

Botërore tendenca për zgjidhen e problemit të Kosovës me formimin e shtetit të Kosovës. Shtetësinë e saj ose të bashkohet me Shqipninë dhe Partia Komuniste Jugosllave Komintern³. Parti komuniste të krejt Evropës e kanë pasë këtë qëndrim që Jugosllavia është shtet artificial dhe duhet të shpërbëhet dhe në mesin e të tjerave gjithë popujt të formojnë shtetësinë e vet shqiptartë të bashkohen me Shqipninë, Kosova t'i takoj Shqipnisë Kominterne.

Ndërkohë, kjo formë e unifikimit të forcës shqiptare dhe të daljes me një qëndrim politik për një ngritje të nivelit të autonomisë në kuadër të Jugosllavisë u përhapë në masë. Dhe në vitin '68 në mes tjerash na si rini i kemi pasur organizu nifare demonstrate të vitit '68 në Prizren, me 6 tetor të vitit '68. Me kërkesë për Kosovën Republikë. Unë jam njëri prej brohoristëve i pari në atë takim që ka qenë prej nja dy mijë, tre mijë vetësh para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ku janë, është hapur flamuri shqiptarë e domethonë mes tjerash është kërku edhe kjo.

Por, ka qenë klima e përshtatshme politike dhe akoma nuk e dike kërkush se a po bohet përnime apo s'bohet. A po bohet republikë, a po ndahemi prej Serbisë, a kemi fuqi m'u nda prej Serbisë, a ka rrezik me Serbinë m'u ba përsëri? Dhe nga niveli qendror jugosllav ma vonë ishte kputë kjo shpresë që Kosova të bëhet republikë, por të ngritet në nivelin e krahinës, autonomi si Vojvodina. Na për herë t'parë barazohemi me Vojvodinën me Kushtetutën e vitit '74, edhe është hera e parë që Kosova fiton të drejtën për të pasë kushtetuten e vet. Përpara ka qenë statut, statut i autonomisë së Kosovës, statuti. E ky sikur komuna, domethonë status i autonomisë në kuadër të Serbisë. Do të duhej Kuvendi i Serbisë me aprovu statutin tond. Tash Kuvendi i Kosovës me aprovu Kushtetutën e Kosovës ishte një prej kërkesave tona. Na ishim atëherë në mes tjerave edhe universitetin edhe të drejtën e vetëvendosjes pa e përmend Shqipninë...

Anita Susuri: Po më intereson gjatë qasaj kohe a keni pasë ndonjë lloj organizimi apo si ka qenë kjo? Apo vetëm i keni plasu në shoqni?

Meriman Braha: Kemi pasë organizim, joformal ilegal, jo shoqni. Qikjo shoqni, kryesisht prej studentëve e ka organizu këtë manifestim që më vonë është qujtë si demonstratë, me të cilën kërkohet Republika e Kosovës, Kushtetuta e Kosovës, Universiteti i Kosovës. Këndohen kangë patriotike në atë kohë për flamurin kuq e zim por nuk është fy asni udhëheqës i Jugosllavisë, as nuk është madhnu asni udhëheqës i Shqipnisë. Nuk kanë përmend udhëheqës fare.

Na të tanë, ka zgjatë nja katër-pesë orë kjo, nuk kanë thy, nuk kemi thy, nuk kemi... as s'kemi djegë, as s'kemi rrzu. Por, kjo mandej osht' përsëritë në Suharekë, nja dy ditë ma vonë. Mandej në Pejë me 19 nandor e ngjashme si në Prizren. Se kam pasë shokë të asaj ane të cilës kanë shku e kanë bo atje si Isa Dema, [Zymer Neziri](#) e të tjerë. Në Suharekë ka qenë Haxhi Bajraktari me shokë dhe u banë... ktu

³ Kominterni (Internacionalja Komuniste), ose Internacionalja e Tretë, ishte vazhdimësi e Ndërkombëtarëve që më parë kishin qëllimin e një organizate komuniste. Deri në formimin e Kominternit, ishin dy ndërkombëtarë, të krijuar në seancën në Bazel dhe në Kopenhagë.

dënimet janë ba për kundërvajtje. Jemi mbledhë, jemi tubu pa leje të njerëzimit, pa leje të organeve të pushtetit dhe kështu është zhvillue.

Në fakt, ne kemi tentue ni herë me ba ni organizim me 10 qershor që është dita e Lidhjes së Prizrenit po kemi dështu. Nuk kemi mujtë m'u organizu mirë se na bonen pikë e pesë, as vet nuk e di qysh na, qysh na kaq shpejt, nuk arritëm. Po kurorën që kishim ble për me e vendosë në Lidhje të Prizrenit e kishim rujtë të një Rema, Hasan Rema, ka qenë shitës i "Rilindjes". Në ditën, me 6 tetor e kemi marrë kurorën e bleme dhe e kemi vendosë në Lidhjen e Prizrenit. Na jemi dënu atëherë katër vetë kah 15 ditë për kundërvajtje...

Anita Susuri: Ju ka marrë policia edhe qashtu...

Meriman Braha: Policia ka bo fletë-dononim për vepër penale, sepse jemi mbledhë, kemi bo ktë, kemi bo ktë... edhe gjykata ishte hala në dilemë çka po bohet me asi, pyetje të mdhaja bojshin, shumë pikëpyetje ka pasë. Dhe ata nuk e morën për... dy herë policia, dy kallxime penale për ne i ka ba në gjykatë, por gjykata ka qenë me gjykatës të ri që kanë ardhë aty, sapo kanë ardhë shqiptarë ka qenë ni Nik Lumezi, kanë qenë pastaj Pirana e do tjerë. Ata nuk e cilësojnë veprën tonë si vepër penale, por si kundërvajtje dhe na japin kah 15 ditë. Hajt udha marë!

Masi u bonë protestat në Prishtinë edhe në tri-katër vende tjera të cilat i kanë bo të njejtat kërkesa si na, e kta i kanë dënu për vepra penale pastaj, politike. Sepse u ndrru, mrena ni mujit u ndrru shumëçka në klimën politike në Kosovë. Veç i kanë dënu, në mesin e tjerave edhe për kushtetutën edhe për vetëvendosjen edhe për të drejtën, edhe për universitetin. Domethonë, të gjitha ato atributet të cilat na i kemi kërku atëherë i kanë kërku edhe kta. Kta janë dënu për gjana të cilat, të cilat i kemi kërku edhe na. Veç na për ni muj ma herët dhe qikjo na ka shpëtu pa dënime. Mund të dënoheshim edhe na, po s'mund të dënoheshim shumë, shumë, sepse fundi i fundit ishte për të mirën e këtij populli. Dhe nuk mund të dënohej shumë. Mund të dënohej ni vit a dy por në dënime të ndryshme se i ban shteti, një, dy vjet nuk ishin shumë për ato që kërkohej.

Tek atëherë në vitet e '70-ta u aprovu kushtetuta, u çel universiteti. Viti '70-të u çel universiteti i Kosovës, me 15 janar të vitit '70-të, 1970 u bo universiteti i Kosovës. Ishte risi e madhe. U shty ni ushtri e madhe, sulm në universitet me nxanës e asi edhe shkollimi i jashtëzakonshëm dhe e bani që pastaj të zhvillohen me forma të përshpejtume rezistencat ndaj Serbisë dhe ndaj politikës utilitariste serbe, serbo-madhe. Deri në vitin '81, '81-shi është shpërthim i demonstratave. Unë kam qenë profesor në shkollën e mesme teknike një pesë metra prej ktuhit edhe ka qenë shkolla ma e madhe, 2700 nxanës po kanë qenë edhe serbë edhe shqiptarë. Por, një dy mijë nxanës shqiptarë kanë qenë. Është shumë numër i madh i tyre.

Kanë marrë pjesë po ashtu në demonstratë, nxanësit, në demonstratën e Prishtinës, kom marrë pjesë edhe unë me nxanësit e mi. S'jam nda prej tyre. Dhe pastaj me datën 1 prill, me datën 2 prill, me datën

3 është gjendje e jashtëzakonshme dhe fillon procedura tjetër. Burgosja masive e njerëzve dhe pagesa me burgime afatgjatë të shumë grupeve, të shumë njerëzve, të shumë të rive aq sa burgje të mbushuna u bonën plot dhe shpërthejshin prej rinisë, prej numrit të madh të burgosurve shqiptarë. Në mesin e tyre jam burgosë edhe unë. Jam dënu në vitin '83, në shkurt të vitit '83 me shtatë vjet...

Anita Susuri: Para se me vazhdu te vitet e '80-ta, '81 e kto se janë shumë të rëndësishme. Po du pak me u kthy te shkollimi ju, vazhdimi i shkollimit në Prishtinë. Qysh ka ndodhë? A ka qenë vështirë për juve edhe si familje që e keni pasë ni prapavijë si të përndjekur po edhe jeta e ju qysh ka vazhdu në Prishtinë?

Meriman Braha: Po. Ka qenë n'atë, domethonë unë e kam krye në Prizren Shkollën e Lartë Pedagogjike, pastaj jam regjistruar në fakultet, me vazhdu vitin e tretë e të katërt por ngjarjet e vitit '68 burgosja, pengoj, ngadalësohej në asi dhe pat pak probleme në universitet. Duhej tash edhe profesorët me i kursye, ti s'mujsh me i thonë kalom e regjistrom e duhej me asi... dhe përgjithësisht deri në ato vite, në ato vite të '70-ta unë tash jam detyru në ato vite të '70-ta të regjistrohem, të kaloj në privat, domethonë me korrespondencë.

Ndërkohë m'u deshtë dy herë, një herë u largova se pata fillu me punu në shkollë tetë-vjeçare në Korishë. Pastaj, më largunë prej atyhit. Masandej konkurova për në Kamenicë, Kamenicë. A e din ku është Kamenica? Në fund. Dhe atje m'pranunë, po nuk më njifshin, nuk e dishin kush jam. Masandej u pranova edhe në Gilan, në gjimnaz të Gilanit. Nuk e dishin taman derisa e morën vesh, unë ndrova në atë kohë dhe dola prej gjimnazit të Gilanit pastaj në shkollën e mesme bujqësore në Prishtinë. Pastaj prej atyhit shkollën e mesme teknike. Krejt, gjatë tanë asaj kohe që isha në punë kam qenë iurvejum dhe pritej çdo çast burgosja ime. A me këtë grup, a me këtë grup, me këtë grup, me atë grup.

Në fakt, flitet atëherë shumëçka, shumë hapur se nuk jemi, jemi të paknaqur. Po deri në vitin '81 kështu ka qenë, domethonë në ni pritje të vazhdueshme të burgosjes. Vëllau im ka qenë mësues, ka qenë përjashtu prej msusie. Motra ime, dy motrat kanë qenë msuse, të dyjat janë përjashtu prej msusie. Njana ka pasë jetu në Korishë dhe nuk i kanë dhanë asaj punë fare. Tjetra ka punu në Gjakovë dhe në Rahovec dhe e kanë kthy në punë fizike, në punë administrative në mulli, në mullirin e Xërxës. Aty ishte asi... ajo, vëllau u përjashtu prej msusie, po ia gjetën ni punë në administratë në "Komunën" e "Komunën" e këpucave, të prodhimit të këpucave, fabrikën e këpucave. "Komuna" që quhej në Prizren.

Kështu që, ne kemi pasë tanë kohën ishim sikur lepurit nëpër qen. Ngjit njanit... kështu ishte. Edhe në, kanë qenë vite të randa në sigurimin e ekzistencës tane, por megjithatë kemi jetue. Dhe kanë qenë vite të mira, sepse shumë prej rinisë së asaj kohe kanë qenë të frymëzuar me këtë idenë e çlirimit kombëtar, të daljes prej kthetrave të Serbisë. Demonstratat e vitit '81 kanë qenë ekskluzivisht për Kosovën Republikë. Në demonstratën e parë të ditës së parë në Prishtinë prej Këshilli Ekzekutiv është qujtë përpara...

Anita Susuri: Kuvendi.

Meriman Braha: Kuvendi. Deri në, deri në Hotel Grand ka qenë plot me njerëz. Unë nuk e di qysh kanë mujtë me mri me ardhë gjithë ata njerëz, pa telefona. S’kemi pasë telefona të dorës, as s’kemi pasë telefona të shpisë. Kem pasë aty ktu ndonjë telefon të shpisë. Por, se si mblidheshin nuk e di. Kanë ardhë një numër shumë i madh dhe kërkesa kryesore e ditës të parë ka qenë, “Kosova Republikë”. Numër i madh i nxanësve me ta edhe unë, nuk kam dashtë m’i lonë vetëm. S’i kam lanë për asni moment vetëm...

Anita Susuri: A ka pasë edhe kolegë tjerë që kanë ardhë me ju?

Meriman Braha: Po. Kanë qenë edhe dy janë të burgosur, Shyqeri Zeneli dhe momentalisht më doli prej mendsh. Dy pastaj jemi dënu. Ata me ni grup tjetër, unë jam dënu me ni grup tjetër. Ata janë dënu me... Neziri Myrtaj. Njëri është i, Neziri i fizikës, ndërsa Shyqri Zeneli është i gjuhës shqipe. Neziri është dënu m’duket njëmbëdhjetë vjet, Shyqiri katër vjet, unë shtatë vjet. Dhe kta nxanës, domethonë, kanë qenë qindra. Unë tham nxanës, shumë nxanës, qindra. Ndoshta një mijë kanë qenë nxanës prej shkollës teknike. Ka qenë shkolla ekonomike, shkolla, krejt studentët e Prishtinës. Krejt. Dhe të gjithë ata kanë kërku masovikisht me brohorimet për, nuk kanë thy, nuk ka bo askush asni veprim që është implikues që të implikon në vepër penale. Por, kërkesa ka qenë, “Kosova Republikë”.

Në ditën e dytë [parolla] “Kosova Republikë” është ndrru është bo, “Kosova Republikë! Kushtetutë! Ja me hatër, ja me luftë!” Dita e tretë, populli krejt populli ka qenë gjithë ditën në demonstrata. Kanë pru me kamion bukë, sallamë, suxhukë, ujë, me kamiona i bishin, i shkarkojshin, i shpërndajshin. Nuk ka pasë asi solidariteti ma të madh, nuk kam pa. Veç në vite të ‘90-ta, në vite të ‘90-ta, ai solidariteti i vitit ‘81 është bartë në vite të ‘90-ta. Pastaj në ndërtimin e sistemit multi-partiak dhe të ndërtimit të sistemit krejtësisht të pavarur arsimor, shqiptar të Kosovës. Unë jam në vitin... njëni prej themeluesve të Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptar të Kosovës. Jam anëtar i kryesisë së saj, themelues i saj. Që ka marrë prokreativat e një qendre për organizimin e arsimit shqip në Kosovë në vite të ‘90-ta.

Anita Susuri: Ishit duke na tregu për gjithë ngjarjen e vitit ‘81 në demonstrata që ju keni marrë pjesë me nxanësit e juv studenta. Çka keni pa gjatë atyre ditëve? Qysh ka shku krejt ajo demonstratë?

Meriman Braha: Ajo ka qenë ni demonstratë jashtëzakonisht masive. Numër i madh i njerëzve, jashtëzakonisht i madh. Nuk kam pa tubime ma të mdhaja. Përveç në vite të ‘90-ta, në vite të ‘90-ta të tilla. Të gjithë kanë qenë të një zëri, të gjithë kanë kërkuë të njëjtën gjë, “Kosova Republikë”, në kuadër të Jugosllavisë e barabartë me republikat e tjera jugosllave. Kjo ka qenë esenca. A ka pasë prapavijë në të ardhmen si zhvillohet, tek zhvillohet, nuk po hyjmë andej sepse idealet janë për bashkimin kombëtar. Por, derisa të jetë Jugosllavia kështu siç është të jemi të barabartë me të gjithë të tjerët, të dalim njëherë prej Serbie.

Na ishim faktikisht nën dy kapuçë, nën dy robni. E kishim robninë e Serbisë që ishim pjesë e Serbisë dhe pjesë e Jugosllavisë. Dy herë, në dy vretje. Herë, çka linte mangu Serbia, bonte Jugosllavia. Çka linte mangu Jugosllavia, bonte Serbia. Megjithatë, populli ka mbijetë dhe ka pasë në kërkesë të drejtë të vetës, të drejtë politike për të kërkuar ato të drejta të veta të barabarta me të drejta të tjerëve të cilët janë pjesë jugosllave. Nuk është ndëgjju kjo kërkesë, nuk është marrë parasysh. Dhe ditën e dytë ka dalë ajo, “Republikë! Kushtetutë! Ja me hatër, ja me luftë!” Dhe doli që republika s’po vika vet, s’po vika në pjetë e asi... po republika po vika me luftën tanë të përgjithshme dhe në të gjitha sferat.

Tashti, a kanë thye? Nuk kanë thye, nuk ka bo askush asni veprim që është, që çon në drejtim të një veprë politike penale. Kërkesa për republikë është e drejtë e jotja me u thanë dhe nuk thuhej ilegalisht, por thuhej legalisht. Thuhej përpara, thuhej në mënyrë të hapur dhe ti për çka je udhëheqës? Për m’i marrë kërkesat e popullit, m’i shqyrtu. Ti popullit ke mujt m’i thanë, boni gati nja dhetë veta, pesë veta, shtatë veta përfaqësues të demonstruesve vini të bisedoni me ne. Në vend të kësaj, ata janë përgjegjë me gaz lotsjellës dhe me ndërhyrje brutale të policisë dhe me përleshje të policisë me demonstrues. A kishim në dorë gjë? Asgjë. Asnji pjesëmarrës i demonstratave nuk ishte i pajisur me diçka që mund të lëndonte dikë. Dy durë dhe kaq, dhe goja. Kjo që flitej, ndëgjohej. Kjo irritonte dikë dhe udhëheqjen e asaj kohe, udhëheqjen serbe të asaj kohe.

S’kishte njeri për ta ndëgjju taman si duhet. Ndoshta mungesa e autoritetit të figurës autoritare siç ka qenë Titoja në atë kohë, e bënë të... bënë këtë situatë ma të acarume. Por, gjithsesi ata kanë mujtë fare lehtë me ni delegacion të njerëzve të zgjedhur aty *ad hoc* mrena demonstruesve dhe të shihet pastaj përgjigja. Nuk ka. Përgjigja ishte pendreku, ishte shkopi i policit, ishte gazi lotsjellës dhe ma vonë mandej ndërhyrjet brutale, shkelma, shkelma, burgosje dhe shpërndarje me dhunë. Shpërndarja e parë që u bo ditën e parë u bo kryesisht nga dhuna policore dhe nga dhuna e pakontrolluar policore, mund të thuhet, e papërmbytur. Ni dhunë e paparë.

Në ditën e dytë prapë mblidhet ni numër jashtëzakonisht i madh edhe ma shumë se ditën e parë. Prej, deri te Grandi, prej ktuhit deri te Grandi plot ka qenë. A kanë pasë njerëz ndje [ndjenjë] përleshje nuk pytë kush, po përsëri janë plot. Krejt zona e mbushur, krejt hapësira e mbushur...

Anita Susuri: Kjo po thoni me 2 prill [1981]?

Meriman Braha: Me 2 prill, krejt ka qenë e plotësime. Aty kanë marrë pjesë dheta mijëra njerëz. U ndrru parulla dhe në vend të kësaj, “Kosova Republikë!” “Republikë! Kushtetutë! Ja me hatër, ja me luftë!” Dhe përsëri ka pasë ndërhyrje, përsëri gaz lotsjellës. Ka pasë ni përplasje të fuqishme në mes të organizatorëve ndoshta jo, por në mes të pjesëmarrësve dhe të organeve shtetërore. Dhe ditën e dytë ka pasë edhe vrasje. Unë e kam pa, nuk e kam pa vrasjen po e kam pa pasojat e vrasjeve. Njëni prej nxanësve t’mi krejt i përgjakun vjen tu qajtë, “Profesor, na i vranë dy shokë”. Floktë e kresë m’u çunë, po krismat ishin nie po niheshin gjithandej, por nuk e dishe kush po bjen kush po vjen. Te shtëpia e

mallrave Gërmia e Re, kanë qenë në Gërmie të Zahir Pajazitit atje ishte dhe kjo e reja është tash ku është ATK-ja...

Anita Susuri: Te Sheshi Skënderbeu.

Meriman Braha: Te Sheshi Skënderbeu aty të shkalltë, aty kanë qenë do shkallë përballë bankës [popullore]. Kjo ka qenë bankë dikur, kjo objekti tash që është [qeveria]... ma poshtë ka qenë në postë e vjetër, quhej postë e vjetër. Dhe aty i kam pa në mes tjerash këtë nxanësin që e përmenda, vjet ka vdekë ky. Dhe tu qajtë, tu asi... tha, "Sa erdh në ndihmë e shpejtë për t'i marrë dhe i kam ngarku vet", ai i kishte ngarkue, i kishte futë në ndihmën e shpejtë. Kta ishin Asllan Pireva dhe Naser Hajrizi. Nxanës të Shkollës Normale, nuk kanë qenë normalista po në vitet e atyre vitin e tretë e të katërtin, të katërtin më duket, në Gërmie aty në anë të majtë ku tash është AUK-u. Ata kanë qenë, janë bashku me nxanësit e kësaj shkollës teknike, me grupin e madh të shkollës teknike dhe kanë dalë në demonstrata dhe janë vra aty. Nuk e kam ditë, nuk e kam ditë se ata dytë janë, asi, ma vonë e kam marrë vesh. Ma vonë krejt vonë tash vonë, se unë kam qenë drejtor i këtij një kohë, drejtor ekzekutiv bukur gjatë.

Më thotë njani që kishte ardhë m'u interesu për nevojat e veta, për ato, në përfundim të bisedës që kishim tha, "Me kënd folë?" Thashë, "Ti folë me Meriman Brahën", "Meriman Braha", kur t'ka bo në kamb ai, ishte verë, me gjithë gruan e vet. I ka hapë durë, "Kqyrmi durë, kqyrmi durë", ishin çu krejt kranezë [rrëngethje]. "Pse çka ki?" U shqetësua. Çka e shqetësoi atë emri im? "Çka ke? Çka ke?" "Po unë tu kam bashkangjitur ty me gjithë grupin e shokëve t'mi kemi ardhë kemi marrë pjesë në demonstratë, kemi qenë bashkë e aty janë vra e i kam pasë shokë klase, banke, Naser Hajrizin edhe Asllan Pirevën". Edhe mu m'u çunë floktë e kresë përjetë. Mas 20 e sa, mas sa vjetësh domethonë kjo ka qenë para tri-katër vjetësh, ky rrëfim. Domethonë, më ktheu në vitin '81 në kohën kur unë bashkë me nxanësit e mi, nuk mujsha m'i lonë vetëm, ishin të ri, të njomë ishin. Plus asaj kisha për obligim me ju dalë dhe me ju shpjegu pse ndodhin këto gjana, si ndodhin edhe kështu ndodhi.

Pjesa e Katërt

Meriman Braha: Me 2 prill na patën thanë, na me 2 prill ishim në shkollë, në orën e parë nxanësit me i çu te shpija. Përpara me ju folë me asi dhe me ju, mos me i lanë...

Anita Susuri: Me i parandalu.

Meriman Braha: Me i parandalu mos me dalë dhe tashti kishim... edhe ditën e parë kishim këtë detyrë por kush po i nalë. Më erdh në nxanës me vonësë tha, "Profesor", tha, "i kanë mshelë dyrtë, krejt dyrtë i kanë mshelë. Menzi që hyna mrena në shkollë. U mushë shkolla me policë, me UBD-ashë". "Çka?!" "Hajt", thashë, "se kur të mbyllen dyrtë, hapen dritaret". Kështu i erdh. Dhe shumë kanë dalë prej dritares, dritarës së katit të parë kanë kcy dhe kanë ardhë, kanë shku në demonstratë.

Në atë kohë, unë kam punu edhe kanë pasë ardhë nja dy persona të medresesë dhe po më thonë tha, “Kena ndëgju që je arsimtar i mirë, a kishe pasë mundësi me ardhë me na dhanë msim në shkollën tonë të medresesë?” Ata dy kishin qenë profesora të shkollës të medresesë, ishin hoxhallarë, po ishin civilë kështu pa shallë, mësimdhanës në medrese. Thashë, “Në medrese? Unë vi me punu pa pare”, sepse ata më thanë, “Edhe nëse vjen me punu te na, ki parasysh që medreseja s’ka pare”. “Në medrese vi me punu pa pare”. Pse? Se e kisha mision për të eduku hoxhë me dashtë vendin e vet, me dashtë popullin e vet. Puna e tij është për fe, bindja, po mos m’i shërby të hujit. As të hujit të afërm, as të hujit të largët, as arabit, as serbit, m’i shërby popullit të vet.

Prandaj, hoxhallarët të cilëve unë iu kom dhanë msim, tash më çojnë të fala kaniherë, unë i kam harrue kush i mbanë në mend. Po unë ju kam dhanë... të gjithë nxënësit e medresesë të asaj kohe të ‘81 kanë marrë pjesë në... njëni prej atyre ka ardhë me më pytë, tha, “Profesor, çka të bëjmë na?” “Ku i keni shoktë?” “Ata janë... çka po ju vyn?” “Ku i keni shoktë edhe ju jeni. Jeni pjesë e këtij vendi. Nëse republikë bëhet nesër, bëhet edhe për ty”. Na ju kemi thanë edhe na ka ardhë shpesh herë edhe deri në hetuesi, ata hetues që ishin, “Çka ke ti që po sikletosesh shumë? Po i jep zjerm, ti në vend të inspektorit krahinor bëhesh inspektor i republikës a? Në vend se hetues i krahinës, bëhesh hetues i republikës. Unë përsëri mbetem aty ku jam”.

Pra, është puna e konceptit, a e ke konceptin të qartë? Dhe a din me ia sqaru atij tjetrit konceptin tënd? Me e ba për vete. Na kemi qenë atëherë deri në vitin ‘90-të, na kemi qenë atëherë, ju kemi thanë atyne, “Na e kemi mirë, kthehuni ka na, ejani me ne. Me parti e pa parti ejani ka idetë tona”. Nuk është me randësi a je i kësaj apo asaj partie. Është me rëndësi ideja e cila osht’. E ideja osht’... kta e kanë marrë në vitin ‘90-të, në themelim të Lidhjes Demokratike pluralizëm politik me çanta librezat e partisë komuniste jugosllave me shku me i dorëzu, që na s’jemi ma. Pse? Janë kthy te ideja që e kemi pasë na. Kurgja për veti s’kemi pasë, asni send. Edhe unë për veti edhe sot e kësaj dite unë jam shumë i kënaqur, i kënaqur shumë që nuk e shoh policin serb, nuk e shoh çizmen serbe, nuk e shoh ushtarin serb. Është fantazi kjo.

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pytë pikërisht në lidhje për kta që thatë për rolin e ju si profesor, se me intervista tjera, persona tjerë që kam intervistuar kanë tregu që janë rujtë prej cilit profesor çka me folë, për shembull, po çka ju keni tregu ju atyne përkatësisht? Për çka keni bisedu? A ju keni siguru edhe libra ndoshta që kanë qenë të ndalume?

Meriman Braha: Libra natyrisht kanë qenë të ndalume, por ni numër i madh i librave kanë hy ilegalisht dhe janë lexu shumë. Në atë kohë s’ka pasë studentë që s’kanë lexu. Bile bojshe çudi, kishte student... unë gjatë kohës që kam qenë ktu, atëherë e kam pasë shumë studenta në anën familjare dhe rrethi shumë, me shumë studenta vishin, hyshin, dilshin. Edhe ndëgjoshin konceptet, pikëpamjet dhe ata bojshin gara kush me lexu ma shumë. Përveç në mjekësi, për shembull kishte kanë pasë librin qikaq {tregon me duar trashësinë e librit} katër orë gjumë s’i bojke kurrë. I msojke përmendësh me poema,

me poezi të ndryshme të cilat kishin depërtue. Ai me shoktë e vet bojshin gara kush po i mëson ma përpara. Domethonë, ni frymë e madhe e solidariteti të jashtëzakonshëm, identifikim të njerëzve me idenë tane, me idenë e përgjithshme që osht' popullore, po idenë e jetës së barabartë me të tjerët.

Na nuk kemi pasë asnjë kërkesë asnjherë, në asni vend që ne duhet të jetojmë e tjetër duhet të jenë nën kambtë tona. Ne duhet të jemi të barabartë me të tjerët, si të tjerët. A e dini ju që ni kohë të gjatë s'ka pasë fabrika, s'ka pasë punëtorë? Krejt administrata, administrata ma e hershme e bankave, e kontabilitetit, administrata shtetërore, komuna, kryesisht është zhvillu në gjuhën serbe. Na s'kemi pasë ni kërkesë për me heqë gjuhen serbe, le të jetë gjuha serbe, por gjuha jeme le të jetë aty. S'kemi pasë shqiptarë nëpër banka, shqiptarë vonë, vonë kanë hy në banka, në organet e ndryshme policore.

Polici ka qenë sinonim i të keqës dhe nuk ka ditë shqip me folë. Me ni policin me folë shqip, me u çuditë. Ma vonë, në vite të '70-ta ka pasë policë shumë, policë shqiptarë. Ka pasë se u kërku atëherë dhe në ato kërkesa është edhe kërkesa e rinisë, kohës sime, për ndrrimin e politikës së regjistrimit në shkolla dhe universitete. Atëherë u bo unitervisteti. Po shkolla pedagogjike ka qenë kryesisht me serbë e malaezë, kryesisht. Ra Rankoviçi u ndrru klima, na kërku si rini të respektohet çelsi, regjistrimi të bëhet në respekt të përbamjes së popullatës. Ishin 70 përqind atëherë shqiptarë, 70 përqind. Edhe shkolla duhet të jetë me 80 përqind nxanës shqiptarë, jo 80 përqind serb, 20 përqind shqiptarë dhe ndërroi ajo. Janë gjana të cilat nuk janë ba meniherë me shkop magjik. Janë ba me vështirësi dhe me kundërshti të madhe shtetërore serbe.

Asniherë nuk kemi gjetë përkrahje prej Serbisë si duhet, gjithmonë, gjithmonë kundërshtim, gjithmonë me forcë me e mposhtë popullin dhe me lanë në errësirë. Ajo që në Jugosllavinë e Vjetër, në Jugosllavia e Vjetër, ajo e para e 1918-shit, me 1 nëntor 1918 deri në qershor të vitit 1941 me ardhjen e gjermanëve, italianëve nuk ka pasë shkolla shqipe. Kanë qenë absolutikisht të ndalume. Njeriu mos me e pasë të drejtë m'u shkollu në gjuhën e vet. Këtë e kanë ba serbët me ne. Lufta Nacional Çlirimtare i ka premtue që secili në shkollë do të mësojë në gjuhën e vet. Kanë tentu mandej me i mbyllë shkollat shqipe, në fillim i kanë hapë, po u dashtë me thanë, po ka ardhë fashizmi i ka çelë shkollat shqipe. Fashizmi i egër, i zi, krejt bota kundër tyne. Me ardhjen e fashizmit është hapë shkolla shqipe, është hapë administrata shqip dhe fillimi i frymëmarrjes në shkollë është me fashizmin. Ky është realiteti.

Në një prej romaneve të miya e kam të përshkrume këtë. E kam të përshkrume në hollësi, çka i duket, si duket, sepse kta kanë ardhë gjithmonë gjoja me shliru. Prej kujt ti me na shliru? Prej kujt? Me na zhdukë. Me na zhdukë totalisht. Fizikisht me na zhdukë, biologjikisht. Kjo është gjenocid. Përveç asaj që është edhe kulturacid se e kanë shkelë me dyja kamë, me tankë e çka kanë mujtë edhe kulturën shqiptare. Prandaj, u dashtë patjetër me ju shpjegu të gjitha konceptet për çdo gja, për të gjitha segmentet e jetës. Dhe jo të gjithë kanë qenë dashamirës, ka pasë edhe njerëz që kanë mendu ndryshe. Kanë mendu, idealet i kanë pasë në Serbi, e kanë pasë në Beograd kryet. Na e kemi pasë kokën te populli ynë.

Anita Susuri: Pas demonstratave të vitit '81 fillon edhe burgosja që e përmendët, po edhe diferencimi po edhe largimi i njerëzve prej institucioneve, sidomos profesorët. Edhe ju keni marrë pjesë, domethënë i keni përkrah nxënësit e ju. Thatë që në vitin '83 jeni burgosë, po qysh ka parapri...

Meriman Braha: Jo, '81 jam burgosë po '83 jam dënu edhe ka zgjatë procesi i hetimit, procesi i hetimit ka zgjatë shumë.

Anita Susuri: Prandaj, m'u dokë që '83-tën.

Meriman Braha: Ka zgjatë shumë, ka zgjatë shumë. Ni kohë... është ni histori e veçantë dhe nuk është objekt i kësaj po, i këtij rrëfimi, po është ni trajtim i veçantë dhe mu më ka zgjatë diku afër 20 muj, praktikisht gjashtë muj hetimi. Në raste të jashtëzakonshme nëntë muj, e mu më ka zgjatë diku 20 muj.

Anita Susuri: Qysh ka fillu krejt kjo procedura e burgosjes? Ku keni qenë? Sigurisht e keni pritë.

Meriman Braha: Këtë e kam pritë unë, e kanë pritë... burgosja është bo në Prizren dhe një kohë të gjatë e kam kalu në burgun e Prizrenit, nja dhetë muj e diçka në vetmi të plotë pa të drejtë vizitash dhe pa të drejtë komunikimi me familje, as me letra me asi, me vizita. Po unë nuk... e kam mbajtur çdo gja në korniza të mija, mrena. Ma vonë masandej u marrë vesh për kontakte të caktume që janë bo me X personin ose Y personin. Ato të cilat kanë rrjedhë prej asaj ane, më kanë dëmtu mrena, më kanë dëmtu shumë.

Unë natyrisht se fillimisht, absolutisht nuk kam asi dhe kur kam pa që gjanat janë të fiksume, të kapuna mirë dhe u ndalë asi dhe them, "Po, unë jam për atë. Kam qenë me një numër të madh të njerëzve, kam qenë në demonstrata, i kam pa demonstratat, kam qenë në kërkesa, jam me kërkesat e demonstruesve. Pajtohem me to. I kam thanë atëherë i tham edhe tash. Populli im ka të drejtë për të qenë ky që është dhe Kosova ka të drejtë ta kërkojë të drejtën e vet për të qenë e barabartë me republikat tjera". Kjo masandej ka pasë pasoja në tjetër... të dënimit dhe natyrisht që s'mujsha me thanë tash, "Ja valla unë kam gabue, se nuk kam gabu". Tjetër është që s'e ke majtë ti, s'e ke majtë, s'e ke majtë tash u bo nami edhe hajde. Unë jam për këtë. Në dënim u ba, shtatë vjet jam dënu...

Anita Susuri: A ka pasë gjatë kësaj kohe dhunë ndaj juve?

Meriman Braha: Po ka pasë, shumë ka pasë. Ka pasë, po dhuna është pjesë e burgut. Ai që thotë s'ka pasë dhunë është, mundet me, një-dy mundet me qenë... po, pjesë e burgut. Dhuna te dikush sidomos, sidomos ato kur kanë dashtë dikë me thy është përdorë shumë dhunë. Nëse s'e kanë thy atë, e kanë thy tjetrin, ai të ka ngarku ty. Dënimet tona janë ba prej deklaratave të njani-tjetrit, "Më ka thanë, më ka thanë, i kam thanë". U kry, e bajsh me shnet edhe u kry.

Është shumë me randësi që hyn në burg, po shumë me randësi si del prej burgut. Me dalë pastër pa e njollos askënd, as vetën tane. Punë e madhe. Është punë e madhe. Është jashtëzakonisht e arritun e madhe. Ti munësh me kqyrë secilin në sy drejtpërdrejtë pavarësisht prej asaj që dikush i ulë sytë kur të shikon ty, po le t'i ulë, mos t'i ulë. Hajt, sene që ia kam falë atdheut këto vite (qeshë) u bo. Jo zine, po ia kom falë hiç pa e zanë ia kom falë. Nuk ka zbulime të grupeve të njerëzve të asi pa bo gabime, pa bo gabime, pa bo gabime. Dikush ose të zen me kërpesh për dore pikë.

Prandaj, gabimet janë pjesë e jetës të përgjithshme. Në jetë njeriu bën shumë gabime, nuk ka njeri që e ka kalu jetën pa gabime. Gabime të lloj-llojshme. Në kuadër të atyne edhe këto, veçse këto e pagunë me dënim edhe mund të jetë me dënim edhe jetë. Si për shembull, ata djemtë që janë vra në demonstrata. Ata janë vra, ma tepër vet janë vra. I kanë hedhë edhe nga kati edhe gjatë hetimeve, gjoja tentoi me ikë e fluturoi. Prej katit të tretë, katit të katërt i kanë gjujt. I kanë bo llom niherë edhe i kanë gjujtë e kanë mbyllë [rastin]. Shteti munet m'i bo njiqind mijë të zeza, po ti duhet me e pasë unin tond dhe në atë unin tond me u majtë, a uni yt është pjesë e unit të kombit tem, nuk bohet ndryshe. Nuk mundesh të jesh ti jashtë kombit tënd. Ti je kombi yt, uni im është i kombit tim pikë. Nëse e kam ba mirë e kam ba për hir të kombit tim edhe nëse kam gabu prapë për hir të kombit tim kam gabu (qeshë).

Anita Susuri: Po më intereson pse kaq shumë ka zgjatë kjo periudha e hetimeve derisa...

Meriman Braha: Sepse nuk i kanë ra në fije.

Anita Susuri: E me ju lshu s'kanë mujtë...

Meriman Braha: Nuk kanë dashtë. Dhe masandej nuk i kanë ra [në fije], ni kohë të gjatë nuk i kanë ra. Është shumë me rëndësi qysh din ti me u majtë (qesh). Qysh din ti me u majtë, qoftë me përgjegje qoftë me dhunë. Nëse e shohin që ti nuk... ata munden me të mytë pa problem. S'arritesh [s'thyhesh], nuk të mysin, duhet me të pru në gjendje të një thirrje për me u poshtnu ti, për me u bo, me ia lëpi çizmen, "Jo, nuk ia lëpi". Kjo ka qenë motoja e asaj kohe dhe motoja e njeriut është përgjithësisht, njeriu lidhet për fjaltë e veta.

Anita Susuri: A kanë, sigurisht ka ndiku edhe prapavija familjare?

Meriman Braha: Natyrisht. Shumë, shumë.

Anita Susuri: Domethonë edhe kta e kanë mbajtë si ni arsye ma shumë...

Meriman Braha: Kjo është, në mesin e tjerëve nuk e di a ka raste tjera që janë mbajtë kaq gjatë po s'kam pa ashtu kaq gjatë. Punë e madhe. Nji herë po ma bon njëni tha, në Beograd ka qenë hetues se kryesisht me ata, ata më kanë, kta tontë kanë qenë argatë, "Po detyra jonë është me zanë, detyra jonë

është me zberthy, detyrë e jotja është me qëndru. Pikë”. Çka ki me i thanë ti ma shumë se kaq, ai po ta thotë troç.

Anita Susuri: E kto 20 muj po më duket më thatë që keni qenë në vetmi?

Meriman Braha: 13 muj kam qenë në vetmi.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë kta muj?

Meriman Braha: Të randa. Vetmia është ni dënim i veçantë. Vetmia shkakton trauma të mëdha. Vetmia shkakton harresë të madhe. Harron njeri gjana të cilat në jetën normale është e paimagjinueshme.

Anita Susuri: A keni pasë të drejtë me lexu diçka ose?

Meriman Braha: Herë për herë. Kishte kohë, në periudha të caktume krejt pa lexim, as gazeta, as revista, as libra, as kurgjo. Kaniherë lejshin libra. Por kryesisht, kryesisht jo. Edhe ka qenë vetmi dhe me vetën tane. Ti tash duhet, unë i kam pa nëpër burgje tu ba zhurmë të madhe prej vetmisë, tu ikë njerëzit. Unë aq shumë m’u dukë s’disha me konceptu si mund të jem unë në ni rreth i cili s’osht’ vetmi. U msova me vetmi se m’u dokë normalitet. Gjendja jo normale në psikën time u bë normale.

Thojsha kur të më bojnë bashkë me të tjerët si do të jem? A do të jem në gjendje të adaptohem me njerëzit përreth? 13 muj. Ka qenë randë shumë, po dita nuk kalonte, ishte e gjatë shumë. Dhe mund ta disha ku jam vetëm atëherë në saje të bisedësh që bojshin me mu ose të asaj që ishte kanalizimi drejt dhe e shishe ku je ti. Unë kisha shumëçka për me folë, prapë më ka mbetë shumë çka pa folë (qeshë).

Anita Susuri: Po më intereson gjatë kësaj kohe, a keni pasë edhe vizita? A keni pasë të drejtë për vizita?

Meriman Braha: Jo, jo, nuk ka pasë. Ktu kur më kanë pru në burgun e Prishtinës ktu kom pasë të drejtë për vizitë, në burgun e Prizrenit s’kam pasë të drejtë.

Anita Susuri: Me grupin që jeni gjyku, a i keni njoftë ata?

Meriman Braha: Pak, pak. Kanë shtu njerëz, e kanë ba për me u dukë grup i madh dhe ato kontaktet që i kam pasë une me grupin kanë qenë të pakta, por të mjaftueshme.

Anita Susuri: Çka keni pritë ju? Sa ka me qenë dënimi apo çka keni mendu para se me u dënu?

Meriman Braha: Po, çka kam pasë me mendu përveç që kanë me më dënu. Qysh me e bajtë dënimin e qysh me dalë, qysh me rujtë ftyrën. Qysh me rujtë ftyrën që dikush mos me ma bo me gisht, “Qitij ia

pashë sherrin”. Mu s’ma ka pa sherrin kërkush. Nuk është me rëndësi sa ia kam pa sherrin dikujt. A mu jo. Për... ti s’munesh me ba, askush asni gjë nuk mundet me bo me gisht me thanë që ky është, që ia kam pa sherrin, jo.

Mu niherë më ka pasë, shumë vite më vonë kur u bo tërheqja e eshtrave të Jusuf Gërvallës e Kadri Zekës. Tashti në varrim që ishte Kadri Zekës tu u kthy po i thotë njani shokut të vet, aq sa unë e dëgjoja. Pikke shi e kisha nifare çadre, aq sa unë po e dëgjoja, “Nuk shkoj bre unë prej ktuhit pa e përqaftë profesorin tim”. Vet me veti... tu zbritë na pasi e krym punën e varrimit, vet me veti po them kush qenka ky profesor që nxansi po thojka po du me përqaftë (qesh). Ai kishte shpejtu hapat pak dhe dul para meje e më përqafti mu. Tha, “Profesor, nal, jam filan fisteku...” po kush po i mban në mend gjithë ata nxanës.

Po më përqaftë ai dhe i tregova atij që e dëgjova qet’ fjalë po nuk e mendova që jam unë, “Jo”, tha, “profesor qysh me të harro ty? 19 vetë kemi kalu nëpër dur të UDB-së për ty”, 19 vetë, nxanës, “19 vetë kemi kalu nëpër dur të UDB-së për ty”, “Ma pasni pa sherrin”, “Jo”, tha, “e kemi pasë nderin” (qeshë), “Jo”, tha, “jo”. “A është dënu kush?” “Jo”, tha, “nuk është dënu. Po na kanë pyetë për ty. 19 vetë kanë kalu”. Tash merre me mend tash aty.

Anita Susuri: Masi e keni marrë vendimin prej shtatë vjetve, ku ju kanë dërgu në burg? Në cilin burg?

Meriman Braha: Po mu më kanë dënu ktu në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës dhe m’u ka dokë mrena dënimeve isha me vetën time isha në rregull, me ftyrën time isha në rregull le të më çojnë ku të dojnë. Ata në atë vit më çunë në Sarajevë. Atje... kushtet e burgut të Prishtinës kanë qenë katastrofale, shumë keq, jashtëzakonisht. Ushqimi ka qenë shumë i keq, fjetja ka qenë e keqe, gjitha kanë qenë të këqija. Atje burgu ishte me tavolinë, dhetë vet ishim në dhomë. Unë i vetmi isha irredentisti. Kur e morën vesh që jamë irredentist secili tu e kqyrë njani-tjetrin, “Khu ktu paska ardhë ni asi...” boshnjak, serb, kroat ishin të vendit të Sarajevës aty. Drejtora, ata ishin për punë ordinere, kishin vjedhë. Ishin nja dy drejtora nga 20 vjet u dënu. Kishin vjedhë nëpër fabrika të tyre shumë. Do tjerë për falsifikime, do për vrasje, hajna plot. Por nantë ishin të tjerë, unë isha vet.

Ata me kurreshtje. Tash, njani prej atyne mas disa ditësh po thotë, “A janë irredentistat qishtë si ti? A janë kështu si ti?” “Jo”, thashë, “nuk janë”, “Si janë?” “Ma të mirë se unë”. “Çka? Khu”, (qeshë) “Une”, tha, “jam djalë i komandantit çetnik”, gjatë Luftës së Dytë Botërore, “edhe ne e kemi pasë bindjen sipas propagandës së këtushme që ju hani gjin [njerëz]. Irredentistat janë përbindës. Nuk janë njerëz janë bisha. Ti qenke jo normal, po mbi normal, ma normal se na krejt. Qenke njeri me kulturë”. Une s’kisha hy se nuk hisha në biseda shumë. E kqyrsha punën time, aty mujsha me lexu, e kisha karrigën time s’ia lshojsha atë vend kërkujt. Qaty u ulsha gjithë ditën, dhoma pak ma e madhe se kjo, pesë shtretër, dhetë shtretër dy katësh edhe ni shëtitje mrena ditës.

Kati i burgut ku kam qenë unë ka qenë kati i tetë, tetë kat, domethënë qaq i madh. Dhe unë nuk ju folsha, lexojsha dhe kqyrsha punën time. Ata bishin, merrshin gazeta. Gazetat e tyre i lexojsha krejt. Masandej gjatë kësaj kohe ai më ka vrejt, “A janë kështu irredentistat?” “Jo”, thashë, “janë ma të mirë se unë, unë jam ma i keqi prej tyre”. “Jo”, tha, “nuk munësh me marrë me mend se çfarë propagande është për ju”.

Ishte njani drejtor po ashtu, ai tha, “Tre muj kam qenë në Kosovë”, “Po çka lype në Kosovë, ti drejtor tre muj”, “Po”, tha, “kam qenë polic rezervist. Rezervist i policisë, nifare komandanti i policisë”, tha, “na kanë çu në Kosovë. Kur na kanë çu në Kosovë”, tha, “na kanë thanë po shkoni në luftë, keni parasysht po shkoni në luftë. Tre muj, tre grada i kam fitu për tre muj”. Domethonë një pasqyrë e jona atje. Me anë të propagandës dhe me anë të pamjes të gjallë të vërejtjes se ti ishte që ti imponojshe vet me faktin tënd që ishte aty. Unë kom pasë domethënë nifare lloj respekti të të gjithëve dhe që ishin armiq, bijtë e armiqëve ishin, ishin serb. Po ata deri në atë shkallë që, “A janë si ti irredentistat?” “Jo, s’janë”. “Pse?” “Janë ma të mirë se unë” (qeshë).

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Ishit tu na tregu për burgun në Sarajevë edhe...

Meriman Braha: Nga burgu i Sarajevës, ni vit kam qëndru në burg të Sarajevës. Atje ajo gjendja fizike e njeriut të mbyllur kohë të gjatë mrena, nuk të lejonte me dalë jashtë në shtetitore dhe dhjetë minuta i kishim shëtitje. Po duhesh tetë kat me zbrit poshtë e tetë kat masnej m’u ngjitë përpjetë edhe na nuk kishim kondicion të mjaftueshëm dhe shumica e të burgosurve thojshin, “S’po dalim hiç, s’po dalim hiç”. Kah dy muj nuk dilshim se tetë kat shumë shkallë, u mushim frymë shumë, u kalbë trupi. U kalb. Mujsh me vu dorën tu lexu edhe me t’metë shenjat në faqe ose me mbetë me gisht gjithë ditën, tamon kalbë. Kështu dukesh mirë, por në fakt ishte i rrezbitun. Rrezbitun në pikëpamje të...

Më vonë, masandej na çunë në burgun e Zenicës, ku ishte puna e randë, puna e randë. Me ajër të papastërt, me, ajri i mbushur me tym, gaz të djegur, ajri i mbushur me aso grimcash të hekurit të skuqur. Ti kur e vishe, sa dy herë kjo tavolinë hekurin e skuqur në një presë ku lshohej ajo presa, ajo e merrte formën e objektit për të cilën ishte presa. Lëshonte edhe aso grimcash të hekurit që masanej e damtojshin, e damtojshin edhe mushkëritë, shëndetin. Dhe sytë damtoheshin shumë sepse shpesh duhej me e pa këtë farë hekurin e skuqur nuk mujsh me e kap ti me dorë po duhesh me mashë.

Kanë qenë masha të gjata edhe duhej me ia ofru, nëse ishte pak e randë, ma e randë dy masha njëri knej tjetri knej, me ia dhanë, me i qit’ në presë për me formësu. Ajo shkaktonte pamje, domethonë te sytë. Ndjersitja, temperatura prej furrës se 50 copa i shtishim në furrë. Ato duhej me u skuq, m’u skuq deri në mosshkrimje, se m’u shkri bohej nami edhe ajo për disa minuta ajo furra ka qenë e veshur me shamot, e mbyllun edhe kur e hapshe derën me pa, m’i pa copat e hekurit a janë skuq a jo boll. Vike

fryma e nxehtësisë edhe e hekurit të, mrena le që e shishe hekurin po i shishe ato tullat e shamotit krejt të skuquna, krejt kuq, krejt furra e kuqe. E kto masandej duhej m'i nxjerrë një nga një dhe dy vetë me masha, herë njani kapte me njani-tjetrin çoja atij për me formësu. Ishte randë.

Aty mujshe me ble, ka pasë kantina. Kantina e burgut edhe mujshe me ble qumësht edhe duhej me pi. Nuk na jipshin. As veshjet nuk na jipshin për mbrojtje prej zjarrit, nuk kanë qenë. Këpucë të zakonshme. Aty digjeshin këpucë po i bike me të ra te kama ajo hekuri. Le që është i randë por i skuqun, shkojke çizmja meniherë. Katastrofë ka qenë. Puna ka qenë e randë shumë, shumë e randë. Ni repart i ka pasë kto prodhojshin do enë, do enë si në formë të hekurta, ato duheshin me u gdhend edhe ishin në gdhentari, gdhendje e hekurit. Hekuri me hekur me atë frezen e shpejtë. Ajo i afrojshim me trup, me trup duheshim me shty atë. E me e majtë se me u lëmu pak. Ajo krijonte shumë pluhun edhe të rrasej nëpër tesha dhe në trup, po edhe në ftyrë.

Kta, ata njerëz që punojshin, kryesisht në këtë punë te brusiona, brusalicë [Srb. *brusolica*] i thojnë asaj gdhentari. Atyne kur dilshin prej pune veç kukurdhoku i syve ishte i bardhë, krejt ftyra ishte zi prej hekurit, ishte ngulitë ajo copë. Ato pastrimet, do pastrime na ato banjot e pastrimeve kanë qenë kolektive të mdhaja se ndryshe nuk mujshe me jetu aty, era i vike. Çdo ditë duhej m'u pastru prej asaj djerse, katastrofë ka qenë. Mirëpo, në pikëpamje të shëndetit u tëhollumë, u shkrimë përneherë edhe unë po edhe shoktë e mi. Ato meniherë erdhën në normalitet edhe fillunë me punu muskujt kah pak, se ishin atrofë edhe muskujt e trupit.

Anita Susuri: Sa orë në ditë keni punu?

Meriman Braha: Tetë orë. Tetë orë në ditë. Edhe ushqimi ka qenë, nuk ka qenë i mirë. Në Sarajevë ka qenë i mirë. Ndërsa në burgun e Zenicës nuk ka qenë i mirë. Kryesisht me pasul, me lakna, me lakna turshi. Të futuna turshi, por të zime. Ato i zijshin. I vike era kumeditë ku. Po për çdo ditë thuajse lakna, për çdo ditë. Pa një herë në ditë e pamundur edhe me qenë vetëm në darkë, po kaniherë darkë e drekë e darkë e drekë. Po ajo shkrimja e trupit dhe kthimi në normalitet me muskuj me asi... ajo e fuqizoi trupin, e boni ma rezistent. E ishim dhe ish kanë ma mirë, e ndjeva vetën ma mirë. Kështu isha kalbë, tamon kalbë. Veç me pa, veç me të ra mishi prej trupit.

Anita Susuri: A keni pasë edhe vizita prej familjes ju në këtë kohë veç keni qenë i martum edhe babë keni qenë? A keni pasë vizita?

Meriman Braha: Ka qenë, ka ardhë gruja, fmitë, nana, vllaznit, motrat sipas rasteve. Po ia lshojshin renin njani-tjetrit.

Anita Susuri: I keni pasë 15 minuta po më duket?

Meriman Braha: 15-20, kaniherë bojshin presion. Ka pasë ni presion niherë, jo niherë po ni kohë që kur të vijnë familjet, sidomos në Sarajevë e në Zenicë me folë serbisht. “Jo, kthej meniherë, kthej meniherë. Nuk flas serbisht. Pikë. Me ty po flas serbisht, je serb po flas me ty. Me nanën time si do të flas? Me gruan time si do të flas? Me fminë tim si do të flas? Nuk flas serbisht?” “Po nuk ka kush me përkthi”, “Mshile, nuk ka. Nuk ke të drejtë edhe pikë, kaq”. Na mandej ankesat, kush po t’i merr ankesat parasysh? Po hajde ankesa thojshim na që po ankohemi. Shkrujshim na ankesa po edhe për të drejtat, për të drejtat e të burgosurve sidomos. Ajo thuhet dhetë minuta shëtitore, po dhetë minuta kurrë s’bohen, pesë minuta, “Jo dhetë minuta, pesë minuta hajde, koha, shko, hyn mrenda”. Kjo ka qenë e randë. Po nuk ka asni në jetë, asni problem në jetë nuk mund të ketë e të mos e kalojë njeriu.

Anita Susuri: Mu po më intereson edhe pasojat që i ka bartë familja ju, jom e interesune m’i ditë? Edhe vllaznit, motrat po edhe familjartë e tjerë.

Meriman Braha: Po ata krejt janë niherë... ma s’pari grua s’ka qenë në punë, s’e kanë lanë me hy kërkund. Masandej, kta që kanë qenë në punë i kanë qit’ prej pune. Kta që i kanë qit’ prej pune e i kanë shti dikund tjetër në administratë është një fatlumësi se kanë qenë krejt msus, krejt thujase familje mësuesish dhe kanë dalë në administratë. Kta kanë qenë në administratë, por e kanë hupë punën, po e kanë hupë punën edukative po kanë marrë ni punë. A kanë mbetë pa punë. Motra ime administrative, ka pasë punën administrative. Tjetra ka mbetë pa punë. Burri i saj ka qenë poashtu i burgosur politik. Atij ia kanë gjetë ni punë administrative, e kanë çu me ni fabrikë administrative, “Qitu ki me punu”, edhe kaq. Domethonë edhe ai ka qenë msus, edhe ai ka vujtë [burgun] Goli Otokun, po nga puna e msusisë në administratë të një fabrike sa me marrë ni rrogë.

Nana e ka pasë penzionin e vet, po penzionin e vet të familjes së dëshmorëve, dhe ajo ka shërby njëfarë forme. Jo në njëfarë mënyre, por në shumë mënyra. Dhe familja jonë ka qenë e lidhun, krejt, ka qenë shumë e lidhun, shumë e përkushtume për njani-tjetrin. Dhe atë që s’e ke pasë ti, ta kam pru une. S’kam pasë une e kam marrë prej teje. Kështu që, ka qenë ni marrëdhënie e shkëlqyer mbrenda familjes me një harmoni të jashtëzakonshme, të jashtëzakonshme. Me vllazën, me motra, me farefis me krejt. Ka pasë ni përkujdesje të madhe edhe nga rrethi.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë për ata me ardhë deri te ju me ju vizitu?

Meriman Braha: Shumë vështirë ka qenë, po unë i kam thanë nanës time, për shembull që të mos vijë, por s’e ka lonë kureshtja. Nanë. Ajo ka ardhë, ka nejtë nja gjysmë ore dhe më ka pa mu. Unë kur e shisha ata 80 e kusur vjeç me ardhë me më pa, 80 vjeç, hej gjithë natën rrugë autobus me ardhë me të pa 15 minuta, dhetë minuta, gjysmë ore... se ato zakonisht qysh qëllojke, me çfarë temperamenti qëllojke, në çfarë situatë, tripa ish.

Anita Susuri: Disponimi.

Meriman Braha: Po. Ai... udhëtimet kanë qenë të randa dhe unë e kisha hallin shumë sidomos nana plakë dhe me fmitë. Gruja me fmitë.

Anita Susuri: Çfarë moshe kanë qenë fmitë e ju?

Meriman Braha: Fmitë kanë qenë në moshë dhetë vjeç aty, shtatë, tetë vjeç, dhetë vjeç, se i kam pasë tre. Bile kjo vajza e vogël, vajza tash e madhe janë në njëfarë asi... dhe nuk m'ka pa kohë të gjatë. Kur më ka pa, nuk më ka njoftë. Po tha, "Ja nisi me më bërtitë vajza", gruja tha, "ja nisi me bërtitë vajza, 'Pse më prune te njeri i huj, e jo te baba'".

Anita Susuri: Po ju nuk keni pasë të drejtë me pasë kontakt?

Meriman Braha: Jo, hiç, veç prej së largu. Nëse janë leju ato vizita, sidomos ktu në këtë burgun e Prishtinës ka qenë, kanë qenë ato farë grilat, grilat e takimeve. Kto grila kanë qenë të ndame katror-katror. Ti mujshe me ia pa njanin sy, s'mujshe me ia pa hunën, s'mujshe me ia pa gojën ose ia shishe gojën s'ia shishe synin, s'ia shishe hunën. Nuk mujshe. Gjithmonë ni pjesë të trupit, një katror mujshe me fiks. Ajo ka qenë shumë... dhe nuk mujshe ti, nëse nuk ishte i madh fmija, ku munet me të njoftë ty në aso situata, nuk mundet me të njoftë.

Anita Susuri: Sa kohë keni qëndru në Zenicë?

Meriman Braha: Tri vjet.

Anita Susuri: Pastaj keni kalu në?

Meriman Braha: Masandej jam liru se i kanë zbritë prej shtatve në gjashtë vjet. Unë kam qenë tu punu kur më ka ardhë ai, "Le punën", thashë, le punën p'e la. "Hajde me mu", unë mas tij. Kur më çoi në zyrën e administratës ata, u kthy polici. Unë mbeta me këta të administratës. Tha, "A e ke prit", tha, "niherë me shku te shpija?" "Jo, s'kam pritë". "Eh po, po shkon te shpija". Unë i thashë, "E kam edhe një vit", tamam edhe një vit. "Jo, sot po shkon". "Mirë". Ishte një befasi për mu, nuk kisha bo kërkesë as ankesë, asni send që ata e donin për me mujtë me u mbajtë në korniza të mija. "Jo", tha, "ti", tha, "sot", tha, "shkon". Masandej procedura, ja ktu, ja aty.

Në burgun e Zenicës ka qenë përveç administratës së burgut, administrata edhe drejtori i burgut e krejt çka ka, në mrena burgut janë zyret e UDB-së, janë zyret e policisë sekrete politike. Policia dhe UDB-a nuk janë një. UDB-a është polici politike. Ajo i ka pasë pesë a gjashtë ndoshta ma shumë anëtarë të vet, punëtorë që punojshin me grupet politike të cilat ishin të ndëshkumë, ishin në grupin e Zenicës. ishin tri grupe të mdhaja politike, ishin shqiptarët, ishin kroatët dhe ishin muslimanët. Kroatët ishin shumë, po ashtu muslimanët ishin shumë. Dhe krejt kategoria e tyre ishte e njerëzve të fortë, njerëz që nuk ligshohen për gjana të vogla. UDB-a punojke aty.

Mu më çojnë më tha, “Jo”, tha, “ti po shkon. Po çka të bëjnë kta tjetër që jeshin ktu”, ata që i kanë barrë, “shoktë tu, filani, filani...” “Ata që e kanë ba jetën e vet përpara meje që tash me ba prapë edhe pa mu”. Kështu që, në fund të fundit unë, më erdh ajo ditë me dalë edhe dola. Ishte në mënyrë të papritur, ishte në mënyrë pak shumë prekëse, shumë. Unë nuk mujsha me konceptu dhe e kisha shumë randë, qysh me dalë e qysh m’i lanë shoktë mrena? Qysh jam taku as vet s’e di me ata që jam taku, çka kam thanë, çka kam folë. Edhe më ka ardhë randë shumë. Megjithatë, kam dalë. Dy jemi liru atëherë bashkë dhe kemi ardhë bashkë në Prishtinë. Masandej kam qenë i papunë, kam nejtë.

Anita Susuri: E kur jeni liru, qysh keni ardhë deri në Prishtinë? A keni pasë me veti pare? A e keni lajmëru familjen? A qysh ka qenë?

Meriman Braha: Jo, hiç, hiç. As familja nuk e dinte, as unë nuk e disha, as kërkush nuk e dinte, as ky shoku është nifare Islami, Islam Morina. As ai nuk e dinte. Dhe kur na kanë lshu neve, mu e Islamin bashkë, na s’e kemi ditë që po lshohemi atë ditë, por na ka ardhë sikur udhës. Edhe tash unë s’e disha që ky shoku e paska ni dajë diku në Bosnje, aty afër Zenicës nifare katuni a qyteti, qytet nashta, Zhupçe. Edhe ni dajë i tij, dajë që ka pasë nifare dyqani, a nuk e di.

Tha, “Jo”, tha, “ky po më thotë”, tha... unë u munojsha m’i hypë autobusit në Zenicë, Sarajevë e prej Sarajeve mandej me pritë autobusin që mundet me pasë ndoshta për Beograd e ndoshta për deri në... e ky tha, “Po shkojmë te ni dajë i jemi”. “Ku ai dajë?” “E kam në filan veni...” Edhe e lajmëroi, jo i shkumë atij, pa prit pa kujtu atij. S’kishim pare me veti as kurgjo hiç, as nuk e dishim. Edhe nëse niherë menoishim me shku me tren po m’i tregue atë [dokumentin] të lirim të që na kanë liru e masanej kur të mrrijmë atje m’i pagu, me gjetë ni mënyrë me ia pagu, s’kishim, qysh me... as na ka... veç me të hjekë qafe.

Kur shkum te ky, e ky i pagoi masanej, ky daja i pagoi diçka nuk e di sa ka qenë, a çka ka qenë. Nejtëm pak aty, ai e kish telefonin. “A ban me lajmëru?” “Bon”. Me telefon lajmërum që na po, na jemi... mezi i mora, i kisha haru edhe numrat e telefonit tem. S’e kisha pasë gruan aty, e kisha pasë te vllau i vet e atij kush me ia majtë telefonin mend, atij atje. Kisha haru telefonin tem numrin, numrin e telefonit tem s’e kisha përdorë edhe m’kish dalë prej menjës krejt. Ndoshta edhe pak habitshëm puna që na ra kështu. Mbas ni kohe, s’po muj me marrë.

M’u kujtu ni numër, numër, tash a ishte i imi, mas nja ni kohe, mas nja ni ore. Tu nejtë tash, s’kisha qysh me lajmëru. Kta te shpija e vllazërve nuk kishin telefona të dy paltë, telefonat krejt numrat i kisha haru edhe m’u kujtu ni numër. Ta marrë edhe niherë, del vllau i grusë, në familjen e vllaut të gruas. Edhe i tregoj që jam unë. “Qysh? Kush? Çka?” (qeshë). Ata të habitun krejt. “Jom valla filani jom, po mezi që m’u kujtu ky numër edhe s’e disha tamam i kujt osht”. Edhe na çoi ky daja pastaj, daja i ktij djalit, Islamit, na çoi me kerr prej atij vendit Zhepçe ku ishte ky e deri te shpija ime, në banesën time në Prishtinë. Patëm fat që ky e gjetë se na kishim nifare odiseadë me mrri ktu. Mezi që erdhëm. Unë volla

rrugës e u bo faqja e zezë. U bo ajo shprehia e madhe, mezi. Udha, po m'del shpirti rrugës prej udhëtimit. E masandej u bo ni gzim i përgjithshëm aty dhe hangrëm ni drekë. Qishtu.

Pjesa e Gjashtë

Anita Susuri: Qysh jeni pritë pas burgut në familje po edhe në shoqni? Se ka pasë raste edhe që kanë ngurru për me pasë kontakt.

Meriman Braha: Po, ka pasë shumë frikë. Familja pak absolutisht nuk ka pasë asnjë lloj përmbajtje, kanë ardhë e kanë shku e kanë asi... dhe qoftë vllazën, kusheri, e tjerë. Po, ktyne tjerve ju kam çu fjalë unë, ju kam thanë, masanej hapen fjaltë, “Unë e llogaris që keni ardhë me më pa edhe nëse nuk vini me më pa. Prandaj, mos u sikletosni me ardhë me më pa domosdo. Nëse vini, llogaritni vet pasojat i i tërhiqni vet, s’jam unë fajtori. Ju, mendja ju. Qysh t’vendosni ju qashtu. Te unë jeni të mirëpritur, po llogaritni që organet e bëjnë punën e vet”. Ajo ka qenë.

Jo, unë kam qenë iurvejum ni kohë të gjatë, të gjatë, shumë të gjatë. Hiç, pa ndërpre. Dhe, domethonë, mrena familjes mirë shumë. Jashta familjes me shumë respekt, shumë, edhe dashuri. Disa nuk kishin mundësi me ardhë se ishin larg, disa që ishin ma afër vishin, disa vishin natën, disa vishin ditën. Varësisht prej njerëzve qysh i gjejshin (qesh). Unë nuk iu kam vu faj edhe mos me pasë ardhë nuk ish bo nami. Punë e madhe! Po pse s’vjen nuk do të thotë që ti je ma i mirë për ata. Shqiptari i mirë është shqiptari i vdekun.

Anita Susuri: Po më intereson mrena burgut a keni qenë në rrjedha të gjanave politike që kanë ndodhë në Kosovë, në Jugosllavi në përgjithësi?

Meriman Braha: Në Jugosllavi po, në Kosovë ma pak ose familja që vishin ato pesë-gjashtë fjalë që mujshin m’i thonë, e kishin ndërtu atë konceptin. Gazetat... mrena burgut mblidheshin shumë gazeta, mblidhnin kroatët, e boshnjakët, e shqiptarët e... Kështu që, ishe shumë i infomum për të gjitha ngjarjet që ndodhshin në Jugosllavi dhe jashtë saj edhe për gjendjen në Kosovë. Mrena familjes aty te ajo, mrena familjes, familja: “Po është mirë ky, ky. Ka mbetë kështu...” Por, unë e kam pasë mbështetjen tanë kohën, gjatë tanë kohës mbështetjen e familjes shumë e kam pasë.

Natyrisht edhe kta e kanë pasë ni asi dhe unë mund me tregue nanën time të zhurbosur, të lodhur, rrugës tanë natën pa gjumë pa asi. Kur ka ardhë me më vizitue, e humbun, e lodhun, e rraskapitun dhe kur m’ka pa me disponim të mirë që jam ballë haptë, e mund ta shikoj, e mund t’i thom, asaj iu shishin rregullimi i ftyrës aty për aty, aty për aty. Tamon mushej, dukej sikur tash po e shoh. E kam djalin mirë. Ju ka hjekë krejt lodhja, krejt derti. Ishte ni emocion i jashtëzakonshëm. Por është shumë e rëndësishme me e pasë njerin tanë, qoftë ai mrena, ti me e pa që nuk është lodhë ai mrena, se s’ke çka i bon. Edhe qoftë për ata tjerë se s’ke çka i bon edhe nga pozicioni i brendshëm.

Në ato vite, kanë shpërthyer shumë probleme. Shumë vrasje të ushtarëve, të burgjeve. Masandej, fillunë shkarkimet e kësaj, grevat e minatorëve, lëvizja për heqjen e autonomisë së Kosovës dhe dyndja e njerëzve prej të gjitha anëve të Kosovës për në Prishtinë. Për t'i thanë botës që s'bon me zvogëluar autonominë e Kosovës, [Azem Vllasi](#), [Kaqusha Jashari](#), e të tjerë. Edhe ato vite kanë qenë vite të përgjakshme, vite të mundimshme. Unë ato vite kam qenë, e pashë gjendjen qysh osht'. Po ni shok i imi e ka pasë çelë nifae' firme të ekonomisë edhe ky, "E kam lanë", tha, "arsimin". Ai arsimtar ka qenë. "E kam lanë arsimin, jam kthyer me tregti dhe a po vjen me më nimu pak?" "Çka me bo?" "Me më nimu". Ai m'ka pagu, nja pesë gjashtë muj kam punu me të në atë firmën e tij.

Masanej ndodhën këto demonstratat e mdhaja të '88-'89-shit në mbrojtje të Kushtetutës së Kosovës dhe autonomisë së Kosovës. Mandej, u suprimu autonomia e Kosovës. Unë kam qenë pjesëmarrës në ato demonstrata të '88-shit, '89-shit. Nuk kam mujtë me qenë indiferent. E bohet çka të bohet se kam pagu, s'mujsha, nuk kam mujtë dhe kam qenë aktiv. Dhe si pasojë e asaj, masanej më 28 mars të vitit '89 unë jam burgosë përsëri. Këtë radhë jam burgosë me, për, njëherë me vendim të Këshillit Ekzekutiv Krahinor për, me izolim.

Masanej, na kanë pasë marrë ni pjesë bukur të madhe të intelektualëve të Kosovës nja 300-400 veta s'di sa kanë qenë krejt edhe na kanë izolue, na kanë mbyllë. Niherë ktu tanë ditën e datës 28 mars, pastaj na kanë çu në Leskovc. Atje kish dalë me autobusa na, gjitha ato një mori njerëz të lidhun. Ni ulëse po, ni jo. E të lidhun me pranga na çunë në Leskovc. Atje, atje u bo ni kasaphane që populli i atjehit kur ka dalë autobusat niherë janë nalë, i rrethun krejt. Me policë, kanë pa njollat rrugës për në Merdarë dhe aeroplana, me helikoptera përmi fluturime të ulta.

Atje serbët ishin qartë krejt, kishin dalë, dojshin me na linque, me na zbritë midis rrugës. Dhe ka qenë randë shumë edhe shumë rrezik. Aty në '89-tën pas burgosjes na çunë në Leskovc. Sikur, e dinte, sikur e priste, priste masa që dikush të vijë, ja kokat tona atje sikur në kohën e Turqisë perandorët turkë. Ata niherë e nalën krejt konvojën, i gjatë shumë, shumica autobusa plot kamanjolla, polici shumë. Sikur me na çue dhuratë neve përshesh diku. Ata kishin qenë njerëz ordinerë, na kërcënojshin, "Kemi me ju vra, kemi me ju pre. Zbritni poshtë!" Dojshin me hy në autobusa, dojshin me hy me zor, dojshin m'i thy dritaret. Katastrofë! Mezi që dikush i nali dhe mas ni kohe, natën, natën vonë hym në oborr të një burgu, të burgut të qarkut. Masanej, aty ni pjesë u shkarku.

Unë e mbaj mend që unë jam shkarku aty. Masanej ni pjesë e njerëzve tjerë nuk ka pasë vend aty i kanë çu në vende tjera, nëpër burgje tjera. Po aty, aty shumë... aty ka qenë ni hapësirë e madhe, nifare holli sa tri-katër herë qikjo e nja 30-40 vetë krejt të përvjelur me ju hy rend të njerëzve edhe hetime edhe dajak pa të pytë se kush je hiç edhe për çka je. "Ti je shqiptarë?" "Po". "Hyni dajak!" Cullak, krejt cullak si të ka lindë nana. Deri sa janë nalë me të fikt, me të rame të fikt. Nuk e di qysh ka pshtu dikush pa vdekë aty, nuk e di. Po...

Anita Susuri: Ju kanë rrahë me armë të ftohta apo...?

Meriman Braha: Me gjithçka... çka kanë pasë në dorë. Ata ishin përgatitë. Në fakt, kam ni njanin prej atyne, "A ke qenë gardien?" Ata civilë kanë qenë, jo të veshun, jo me uniforma. Ka pasë edhe me uniforma po kah pak. Na ka ardhë darka, na sollën darkën. Na ishim në darkë aty edhe ni herë pritje në koridor në rend, mandej nga koridori rend, ato dy rende ishin shumë të ngushta, koridori shumë i ngushtë ka qenë. Edhe në dy rreshta njerëzit afër njëri-tjetrit. Atje kishin ni derë, atje ishte dera me të marrë ty prej ktuhit me të shti aty. Aty bohej nami se ktu pritej nami, atje bohej nami. 30-40 vetë, Zoti e din, plot. Sikur bisha, si bisha.

Nuk e kanë, asnji prej atyne njerëzve nuk e di qysh ka pshtu, asnjëni. Si ka qenë krejtësisht e pa kontrollë tu ba gara njëri me tjetrin. "Lëshoma mu se unë i bi". Tu kcy me kamë, me durë, me shkelma, me gërrbaçe, tu ra me shufra, me gjithçka çka ju ka ra ndërmend. A i kanë pasë gati, a i kanë gjetë aty, a Zoti e di. Po ti nuk ke ditë për vete. Dhe unë si të tjerët kam ardhë në veti të nesërmen, të nesërmen. Kur kanë hy ata... në fakt më ka dalë niherë kllapia, më ka dalë niherë kllapia prej goditjes të dikujt, ni goditje që më vike, që më erdh me më zgju *bum, bum, bum* {onomatope}. Kur i hapa sytë e pashë vetën isha gjysëm i shtrirë, gjysëm i fjetun në shtrat. Gjysma e trupit në patos, gjysma, pak me shpatulla e kisha pasë si i ngrimë. Qishtu më ka dalë kllapia.

Kishte qenë njëni prej atyne, njëri prej shokëve të dhomës tu i ra murit me kry *bum, bum, bum* {onomatope}. Qajo ma ka qit' kllapinë. Unë s'e kam ditë kush osht'. E kisha pasë... gjatë kohës kur ishim në koridor, ishim mrena tu pritë, atje nihej valakama, britma e dikujt. Kur heshte, na nuk e dishim a ka vdekë, a është gjallë? Veç rendi i dikujt është çelë. E dikush erdh prej atyne policëve e kërkoi dikën tha, "*Ko je Vlasi ovde, Vlasi?*" [srb.: Kush është Vllasi këtu, Vllasi?]. Ai ishte Agim Vllasi "*Ko je Vlasi?*" [srb.: Kush është Vllasi?] Tha, "*Ja*" [Unë] "*Izađi!*" [Dil!]. Dul përjashtë në rend, e morën pa rend. Qiky Agim Vllasi është djali i vllaut të Azem Vllasit. Azemi atë kohë ka qenë i burgosur. I burgosur për kundër revolucion...

Anita Susuri: Greva e minatorëve.

Meriman Braha: Po, greva e minatorëve, sikur ky është shkaktar i kësaj. Unë e shoh kta tu i ra, "Ma, ma!" Ku p'e di a kam folë me të madhe, a m'u ka dokë e madhe, nuk e di. Veç e di që qashtu ju kam afru këtij e kam qit' mbi trupin tim, e kam ngre m'u ka dukë sikur ni mal p'e çoj. E kam qit' pak në shtrat dhe më ka ra të fikt. Të nesrit ka dalë kllapia kur kanë hy polictë, sikur të qartun serbët. Kërkush s'ish çu. Katër vetë kemi qenë ni sob, cullak krejt. Teshat të gjujtuna nëpër dhomë, teshat, ato kishin qenë tonat, por të gjujtuna nëpër tokë. Neve na kanë gjujtë se na kanë përplasë, katër vetë. Edhe tek masanej, "Hajde m'u çu, hajde me asi..." Na kanë marrë prapë gjatë asaj kohe. Derisa u veshëm, derisa u mathëm, Zoti e di. Unë nuk e di qysh jemi veshë, as qysh jemi mathë, as qysh... veç e di që të ramet nuk na janë nda asniherë.

Kur më morën mu, me rend, më morën përpara *bum, bum bum* {onomatope}, kur shkoj atje kishin qenë UDB-ashët tu pritë, “Qe”, tha, “Meriman Braha. Po vjen Meriman Braha. I ri me shumë përvojë. Tash ka me folë ky, tash ka me folë”. Kur ia nisën ata me më pytë për Azem Vllasin. Unë s’kisha lidhje me Azem Vllasin. Po mënyra si e sollën, si asi, sikur unë isha një prej njerëzve kryesor në shtabin e organizimit të popullatës edhe që e kam thirrë popullin në kryengritje e kam shtabin kryengritës. Në shtab Azem Vllasi edhe unë edhe nuk e di kush tjetër. I përmendshin do emra që s’i njifsha. Vet me veti kta e paskan sos me ma montu këtë gjykim. Ndryshe nuk ka brina, qishtu montohet, ti je edhe pikë.

Vonë, mas nja dy-tri javësh u mor vesh që Azem Vllasi edhe unë jemi larg shumë dhe nuk mundën me na bo bashkë. Edhe na çunë pastaj prej ktu, prej Leskovcit në Zajëçar. Kemi nirthtë shumë. Atje në Leskovc kemi nirthtë shumë. Kisha pallto, as pallto as këpuca kurgjo si thupra dridheshim. A dridheshim? Jo unë, po krejt, krejt. As me hangër, nuk na punojshin, nuk na bojshin fulqitë me përtypë diçka, bukën, kafshorën e bukës nuk mujshe me përtypë. Çka na kish gjetë nuk e di. A kishim hupë shumë langje, a ku p’e di, s’e di. Ni diçka, u dridhshim si thupra. Dhe sa herë më shkojke mendja, që e shisha vetën thojsha nalu pak, u dridhshim. A e kam prej tute? A e kam prej që është ftohtë? Nuk e di. Po masi nuk dridhesha vetëm unë, po dridheshin edhe shoktë tjerë edhe ata nirthshin shumë, atëherë nuk ishte vetëm tuta. Domethonë është ma shumë se kaq. Kishim hupë diçka.

Për çdo ditë ka qenë, kanë qenë ato edhe në Leskovc edhe në Zajëçar ka qenë autoparlantët mrena në dhomë. Çdo ditë knojshin kangë çetnike, prej mëngjesit deri në mramje. “Kemi me vra, kemi me shku, kemi me shku në Kosovë kemi me vra, kemi m’i zhdukë shqiptarë, kemi me i pre”, kuku kangë po asnja s’e maj mend. Veç ni fjali prej krejt atyne kangve m’u ka ngulitë në kokë, “*Za ideale ginu budale*”, “Për ideale vdesin të budallët”. A llogaritshin që na jemi të çmendur? Na kishim ideal. Po rrethanat ishin ku e ku ma të zeza s’mund të bëheshin veç m’u vra njerëzit, veç m’i vra. 30 vetë në Prishtinë atë ditë, 28-30, a sa janë vra në demonstratat e Prishtinës? Sa janë vra nëpër Kosovë vetëm atë ditë? Unë e kam lanë Prishtinën krejt në gjendje të jashtëzakonshme me tanke, me gjithçka, me aeroplana. Kalojshin për skej mbi autobusa, veç që s’u ulshin. Gjendja shumë e randë.

Ushqimin na qitshin... vizita nuk kishte, asni kontakt nuk e kishe me familje. Shumë të mërëzitur, flaka na dilke. Unë llogaritsha, le që e kisha, harrova me thanë. Në autobusin ku isha unë e prunën ni grup prej Prizrenit, me ta vllaun tim, të dytin, Sarejдинin, dhe meqë na ndajshin kështu dhe ata, vllaun e çunë në pjesën e mrapme të autobusit. Po nuk e dike ky a e kanë marrë vllaun tjetër a jo, s’e dike ata tjetër a i kanë marrë, kusheritë tjerë, farefisnin, kush ka mbetë. “Nuk di gjo, s’di gjo, mu më kanë marrë”.

Kur ka bo vaki, kur atë moment për me më shti në burgun e Leskovcit, me më dorëzu, zakonisht, jo zakonisht po çdo herë, një polic shqiptarë që ishte aty e merrte të burgosurin për me ia dorëzu prej autobusit atyne. Deri me shti, derisa ta shtijnë mrena nuk e shike ma. Po ky, njëni prej policëve, dy kanë qenë policë shqiptar, njëni prej policëve vjen masi e dorëzon njanin vjen na gjunë atë kallashnikovin e vet që e kishte në dorë për podi, “Çka t’boj une?” Po bërtet, si i çmendur. U çmend. Vllai im me dikë prej atyne shokëve atje mrapa, njani prej atyne i thotë, “O komandir, o komandir

kthena qat' automatik. Më vraj mu, falë të koftë gjaku, veç mos më le me shku në dorë të atyne bishave”.

Masi kaloi ajo vala e parë anej, polici që i erdh radha me më dorëzu mu m'u afu tha, “A ke kujtë m'i lajmëru te shpija?” “Po kam”. “Ke telefon?” “Po”. E tregova telefonin edhe ia shkruaj telefonin në dorë, telefonin tem në dorë edhe më dorëzoi. Ma s'e kam pa, kurrë s'e kam pa as nuk ia di emrin. Mirëpo. ai kishte shku me u kthy e kish marrë numrin e telefonit dhe i thotë, nuk i përgjigjet kush osht' veç thotë, “Njerin e keni në Leskovc dhe e kemi lanë keq”. Kaq i ka thanë grusë, gruja u paraqitë në telefon.

Pjesa e Shtatë

Meriman Braha: E tash në Zajëçar ni kohë, dy muj u bonë. Nuk kishim të drejtë as të vizitës, as kurgjo, pëveç kangëve të Serbisë. Kur ni ditë, na ishim tre me ni dhomë, njanin e morën i thanë, “Vizitë ke”, dhe e çunë në vizitë. U kthy ky. Shkoj i dyti, “Vizitë”. Edhe unë tash menojsa, gruja sa e kishte lindë vajzën e vogël e kish, as dy muj jo, niherë ajo s'munët me ardhë. Te familja secili hallet e veta s'ka kush me ardhë. Edhe unë isha i mbështetun, flaka më dilke. Kur po më thotë, “Vizitë”. Ah thashë [me vete] vizitë, po më çon ky në pytje. S'o puna në vizitë, në pytje. Kur shkoj atje p'e shoh motrën time. Ajo dy çanta i kish marrë. Dy UDB-asha në atë anë nga ajo, grilat mrena në mes pak ma të rralla, po grilat aty. Dy UDB-ashë knej kah unë mrena. Edhe ajo tha, “Qysh osht' Hydaja?” “Mirë është”. “E ku osht'?” “Te shpija”, *uhh* {onomatope} më erdh mirë shumë.

Dhandrri tjetër prapë edhe ai i burgosur politik edhe ai te shpija. Qemali te shpija. “Po Sarejdini?” “Sarejdini në Prokuple”. S'ka pasë vend me nalë e unë e kisha hallin e këtij. Tash ky është pak ma i vjetër se unë, po përvojë me polici nuk ka pasë direkt fërkime shumë. Ka pasë aq sa ka pasë, po direkt me provat e policisë... e thojsha ky s'ka, ky ka hjekë ma keq se unë menojsa unë. Ai në fakt ish mush burgu i ksaj i Leskovcit dhe s'kish pasë vend. I kishin çu për Prokuple dhe atje kish kalu pak ma lehtë se kish qenë në vetmi, po nuk e ka hangër qat' zaval sa kemi hjekë na, shumë ka qenë rrezik, shumë.

Ai thotë, “Lemni mu!” I kish thanë familjes. Gruja i kish shku, “Mos më kqyrni mu. Shifni Merimanin, ai është në rrezik. Çka kanë me më bo [mu]?” Edhe kur e marrë vesh atë, “Mirë”. Unë... filloi me m'u hjekë merzia, m'u çelën sytë. Ajo tash, të kam pru ktë, të kam pru ktë “*Ne može*, s'bon, s'bon, s'bon”. Dy çanta plot i kish marrë, të gjitha sendet jo. Metën në dorë tre limona {ngrehë dorën sikur mban diçka në ajër}, “Qeto?” “*E to može*, e ato mund”. Edhe m'i dhanë mu tre limona. Kur u ktheva në dhomë i gjujta në shtrat thashë, “Qe, hani limona” (qeshë). I tregova atyne që motra ma hoq atë mërzinë që e kisha.

Ka qenë shumë randë po dikur kryetari i Jugosllavisë ka qenë Drnovsheku⁴ i Sllovenisë. Ai, bohet e madhe kjo puna jonë që në Leskovc, nihet, vijnë komisionet shtetnore, republikane për me na pa me i

⁴ Janez Drnovšek (17 maj 1950 - 23 shkurt 2008) ishte një politikan liberal slloven, President i Jugosllavisë dhe President i Sllovenisë (2002–2007).

matë të ramet, ku na kanë ra, sa na kanë ra. Nifarë kallafati⁵. Po megjithatë u bo e mirë se u bo e madhe, doli kjo si shishja, si dreqi prej shishes dhe u nal dhuna. Edhe mas nja dy mujsh u kthym na po, “Hajde po ktheheni”. Njani shkoj, tjetri shkoj, unë po pres. Kur erdhën edhe tak m’i lidhën durty, në Maricë të Serbisë edhe njani i Pejës, Ahmet Zeka, edhe ai me mu. Ktu na prunë në Prishtinë. Ata e çunë për Pejë, mu më nalën në Prishtinë. Gati, s’e di, edhe ni muj gati.

Gjatë asaj kohe ka qenë... po ni natë përpara, jo, ni natë mas ka qenë 28 qershori. 28 qershori është Vidovdan. Vidovdan është dita e luftës 1389, Vidovdan. Edhe thojshin, në asi dhe më futën me ni dhomë ku ishin tre-katër vetë. Nuk isha ma vetëm, nejta me tre-katër shokë tjerë. Edhe na i nijshim ktu tu qarkullu, njerzit tu knu Serbia, Serbia rreth burgut të Prishtinës. Po dojnë me hy mrena, me 28 qershor. Dojshin me hy mrena m’i pre ata të burgosurit shqiptarë.

Thojshin që atë ditë kanë pasë me burgosë edhe kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova ka qenë. Jo p’e bijnë, jo s’pe bijnë. Më duket nuk u pru. Veç me ardhë nuk erdh. Nuk na asi... po UDB-ashët e Beogradit kanë qenë aty. Kta tontë argatë me na marrë me na pytë me na asi. Unë jam ndër ata, më kanë thanë s’paku, “Ti po lirohesh, po shkon te shpija. Je i fundit që lirohesh prej të burgosurve politikë izolant”, dhe qishtu. Kjo ka qenë histori e dhimbshme shumë.

Anita Susuri: Sa muj këtë radhë keni qenë i burgosur?

Meriman Braha: Kjo ka qenë tre muj e gjysë, gati katër. Ishte urdhëresa e presidentit të Jugosllavisë atëherë ka qenë që të mos mahen njerëzit në izolime, po tu hapet hetimet dhe të kryhet puna për hetime ose të lirohen nëpër shpija. Meqë s’kanë mujtë me fakti që s’jam anëtar i shtabit të Azem Vllasit më lirunë te shpija. “Po të lirojmë. Shko te shpija, por dije që mas na ke”.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj vitet e ‘90-ta për juve? Atëherë bohet edhe largimi prej punës.

Meriman Braha: Po, viti ‘89. Kah fundi i ‘89-tës po më thojnë, “Hajde, a po vjen se po formohet ni parti”, Lidhja Demokratike, thashë, “Nuk është mirë m’i marrë të burgosurit politik meniherë. Lena niherë të marrim frymë pak. E dyta, ata që marrin pjesë në themelimin mos të akuzohen meniherë për irredentizëm. Nëse na shkojmë meniherë i thojnë nacionalista, shovenista shqiptarë. Masanej e japim kontributin na”. Kështu që, nuk kam shku. Unë kam qenë i njoftun, po nuk kam shku dhe i kam ndalu ata që kam mujtë mos me shku për mos me i kompromitu punën që mund ta bëj një parti. Ma vonë masanej jam angazhu.

Në vite të ‘90-ta kam qenë pak ni kohë aktiv në themelimin e degëve të kësaj, të Lidhjes Demokratike. Kam marrë pjesë në themelimin ‘90-shi, në themelimin e arsimtarëve, të grupit të Shoqatës së Arsimtarëve Shqiptarë të Shkollave të Mesme. Masanej kam marrë pjesë në themelimin e Lidhjes së

⁵ Kur një punë bëhet pa kujdes, shkel e shko, sa për të thënë se u bë; i jap një lustër sa për tu dukur e mbaruar, i jap një kallaj.

Arsimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri”, në fund të atij viti. Dhe mandej jam marrë kryesisht me problemet e arsimit, me problemet e arsimit. Me arsimin mrena Kosovës dhe me arsimin në diasporë.

Po në vitin ‘91 kam pasë ni burgosje tri-katër ditëshe. Me një malltretim të madh fizik dhe me një gjendje të randë fizike shumë dhe me një kërcënim për jetën deri në asi... dhe u pa e arsyeshme që të mos i shkoj, të mos shkoj ma në dorë tyne. Kështu që, në vitet e ‘90-ta jam detyru të largohem prej Kosove dhe kam dhanë kryesisht kontributin në arsim në diasporë, nëpër vende të Evropës, por edhe në Shqipëri.

Anita Susuri: A ka qenë ajo hera e parë qato vite të ‘90-ta që keni shku në Shqipëri?

Meriman Braha: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë ai përjetim për juve?

Meriman Braha: Shumë i randë, shumë i ranë, i pabesueshëm, shumë i randë, tepër i randë. Po duhet me gëlltitë ashtu siç është. Vendi ynë, s’kemi çka me bo, po tash sa kanë pasë mundësi.

Anita Susuri: Po pse ka qenë i randë? Ndoshta pritjet e juja kanë qenë ndryshe?

Meriman Braha: Për të gjitha, për të gjitha. Une kam shku në ni kohë kur atje mungonte çdo gja edhe uji edhe buk, edhe drita edhe njeri. Nuk kishte. Njeriu është tjetërsu, ka dalë jashtë lëkurës të vet. Njeriu, unë nuk e di si ka qenë përpara, por përpara është mendu se mund të jetë një njeri i mirë. Po, në ato kohë kur kam shku une, kam shku në kohën ma të keqe të mundshme. Kur anijet për ikje prej Shqipërije u mushshin u bojshin kalavesh rrushi, kur nuk mupshe asgja me thanë lumë e shyqyr, për asgja. Policin e shishe që s’i vike era polic, ushtarin e shishe që s’i vijke era ushtar. Katastrofë!

Po qishte si ti po më pyt njani me një darkë të madhe, “Si po të duket Shqipëria?” “Po më duket terr, zi, keq sa s’bahet”, ishim plot, shumë, “por dashuria ndaj Shqipërisë nuk më është zbeh as kaq {shpjegon me duar që as sa maja e gishtit}, dashuria mbetet njëjtë, pavarësisht për krejt të këqijat për të cilat jeni përgjegjës ju. Nëse s’ka drita përgjegjës jeni ju, nëse s’ka ujë përgjegjës jeni ju, nëse s’ka bukë përgjegjës jeni ju”. Ata janë vonu në demokratizim pak, jo pak por shumë. Prandaj ngrehej zhag, shumë.

Anita Susuri: Du me ju pytë edhe për vitet e luftës kur faktikisht ka fillu prej ‘98-tës me vrasjen e Familjes Jashari, pastaj masakrat që janë bo në Qirez, ju keni qenë jashtë gjatë asaj kohe?

Meriman Braha: Unë kam qenë kryesisht në atë kohë, kam qenë në Tiranë.

Anita Susuri: Qysh i keni pa krejt këto ngjarje? Qysh i keni përjetu?

Meriman Braha: Po lufta ka qenë e pritshme. Na s'kemi qenë të përgatitur për luftë. Na s'kemi qenë. Na në asni aspekt s'kemi qenë. Përveç në aspektin solidariteti vite të '90-ta që ka qenë nifare solidariteti që nuk mund të përshkruhet. Lufta, shpesh ma kanë bo edhe jashtë edhe nëpër shumë takime, krejt Evropën kam ecë, s'kam fjetë dy netë me ni vend dhe zakonisht nuk kam fjetë nëpër hotele, s'kam pasë pare. Kam fjetë nëpër shpija dhe ju kom thanë atyne që ma japin bukën e konakun, "Faleminderit për konakun e bukën, por borxhin ia kam Kosovës jo ty. Ty ta kam falenderimin. A borxhin Kosovës ia laj me ata që kam".

Më kanë pytë shpesh, "A mendon që kjo punë kryhet pa luftë?" Nuk mendoj. Kam thanë, "A e doni mendimin tim? A e doni mendimin zyrtar?" Kam qenë funksionar arsimor, i Ministrisë së Arsimit në ekzil. "Nëse më pytni për vetën time, për mu, unë mendoj që nuk bahet pa luftë. Nuk më ka marrë malli për luftë fare, hiç. Nëse dikush e din çka është lufta e di unë e din familja ime. Nuk më ka marrë malli për luftë. Por qare pa luftë nuk bahet, sepse serbët nuk hjekin dorë, pa luftë nuk hjekin dorë. Të jesh njiqind përqind nuk hjekin dorë. Edhe shqiptartë të mushin krejt Kosovën shqiptarë nuk hjekin dorë."

Ata s'hjekin dorë as prej Shqipnisë. Qit' Shqipninë e dobët, kështu e dunë ata të shkatërrume, të coptume, të pa bashkume kështu e dojnë. Sepse [Serbet] androjnë që vjen ni ditë që dalin në detin Adriatik, e pengesë i kanë shqiptartë. Prandaj thojnë, "*Dobar Albanac samo mrtav Albanac*, shqiptari i mirë është vetëm shqiptari i vdekur dhe mundësisht pa varr", që t'mos kenë ku me iu falë varri. Unë mendoj që pa luftë nuk ish bo kjo. Kështu kanë mendu edhe qarqe të cilat kanë vendosë për Kosovë. Edhe problemi i ndërhyrjes është me ndihmë humanitare për me shpëtu popullin prej gjenocidi. Popullin shqiptar prej gjenocidi. Këtë e ka shpëtu NATO-ja. Prandaj, luftën na duhet ta bëjmë, me u anku duhet të ankohemi, të flasim, të bëjmë. Po punën, e ka kry praktikë të dëbimit të serbëve prej kësaj ane vetëm NATO.

Anita Susuri: Në vitin, po menoju në vitin '99 ktu ka ndërhy edhe NATO-ja me 24 mars, ju keni qenë jashtë Kosovës, po a ka qenë edhe familja juj ktu dikush?

Meriman Braha: Po kanë qenë. Kanë qenë ktu, ktu kanë qenë krejt përveç familjes time të ngushtë. Se djemtë i kam pasë, dy djem i kam, të dy kanë qenë në luftë. Dhe ata e kanë ndërpre studimin kanë shku në luftë. Tash e kanë ndërpre luftën merren me puntë e veta (qeshë), kanë kry luftën dhe kanë krye me faqe të bardhë. Unë kta tjetër të familjes time, vllau i madh vdes tu e përzanë prej shpije, te dera e oborrit. Vllau tjetër vdes nja disa muj përpara prej torturave ma të hershme që ka kalu nëpër burgje nëpër asi dhe ka pasë ni torturë të randë prej UDB-ashve. Ajo i ka shkaktuar pastaj probleme me zemër dhe ai ka vdekë ma herët pak, po në periudhën e luftës. '98 njani, '99 tjetri.

Anita Susuri: Qysh, po mendoj a keni pasë kontakt? Ose qysh, çfarë mënyre keni mujtë me pasë kontakt me djemtë që kanë qenë në luftë ose s'keni pasë kontakt?

Meriman Braha: Jo, ata kanë qenë në luftë dhe unë kam pasë kontakt, sepse shumë kontakte kom pasë, me shumë njerëz të luftës. Dhe më kanë njoftu për të gjitha. Veç kur u plagos njani në kamë nuk më kanë njoftu edhe pse kam qenë afër kufirit. Kur kam ardhë ktu e kam marrë vesh. Atë ditë kam, mu në kufi kam qenë dhe s’e kam marrë vesh. Dhe ata e kanë ditë, po s’më kanë kallxu. Kanë dashtë me kalu, “Hajt nashta e merr vesh ma vonë ma mirë”. Masi ai nuk ka mbetë me pasoja të randa, mirë boll. Unë jam i lumtur që nuk kanë ra ata, po edhe me pasë ra s’kam çka me bo. Ka qenë zgjidhja e tyre.

Anita Susuri: E kur jeni kthy?

Meriman Braha: Ata, ata e kanë vendosë vet. Më kanë thanë që dojnë me shku me luftue ‘98-‘99. Ato dy vjet i kanë thuat të plota në, dy vjet të plota jo, ‘98 të plot e këtë tjetrën deri në çlirim, ‘99-ta. Thanë, “Na jemi për me shku në luftë”. Ishin në studime, njani elektroteknikë, tjetri juridikun. Dhe, “A bon me shku?” “Njani me ardhë”, p’i thotë gruja ime, bile dy djem mos me shku, se ai ditën që shkon ti...

Anita Susuri: Është i rrezikum.

Meriman Braha: Është i rreziku,, ti duhesh me llogaritë që ke me marrë...

Anita Susuri: Që s’mundet me u kthy.

Meriman Braha: Që s’mundet me u kthy. Dhe, “Jo”, thonë ata, “secili për veti”. Njani po më pytë, “Babë, çka kishe bo ti me pasë qenë në moshën tonë?” “Ju a po pytni babën?” “Po”, “Unë s’e kisha pytë hiç, veç kur kish marrë vesh” (qeshë), “Unë s’e kisha pytë hiç”.

Anita Susuri: E që thatë keni ardhë në kufi në Kosovë, kur ka qenë kjo që jeni kthy?

Meriman Braha: Jemi kthy masanej, meniherë jemi kthy masi u kry lufta.

Anita Susuri: Qysh e morët lajmin që ka përfundu lufta?

Meriman Braha: E kemi shiku. Më ka pasë... në orën 2:00 të natës, 3:00 të natës më merr dikush në telefon. Unë djemtë i kisha në Koshare, përtej në Koshare në atë zonën e ashpër të luftës me serbët që e kanë pasë. Edhe po më merr njani në telefon, po më merr dikush në 3:00 të natës. Thashë në 3:00 të natës veç ni hall i madh, ishte lufta në përfundim, qaty 10, 11, 12 [qershor]. Dhe po paska ndodhë, paska ndodhë. “Alo!” Po më lajmërohet ni shok, “Si je? Të çova prej gjumit?” “Po, po prej gjumit u çova”. “Si je? Mirë?” Ai shoku ka qenë Mustaf Sopi.

Mustaf Sopi ka qenë njëni prej, kem punu bashkë në arsim. E ka pasë ni djalë e pesë çika, qiky djali i vetëm iu ka vra në luftë dhe unë qatëherë e pata marrë vesh, pak para përfundimit të luftës. Thashë,

“Po më vjen keq, s’kam mujtë me të marrë ma herët”, “Jo s’ke mujtë me më marrë, se unë në mal jom. Po s’keni çka me bo. Veç të mora në telefon me të lajmëru që po hyjmë nesër në mëngjes. Sot në mëngjes jemi në Prishtinë”. Ishte ni sihariq shumë i madh, “Faleminderës shumë që të ka shku mendja me më lajmëru. Urime dhe me faqe tëbardhë!” Qishtu.

Anita Susuri: E kur u kthytë, çfarë gjendje e gjetët Kosovën?

Meriman Braha: Në gjendje të keqe. Niherë ma së pari njerëzit do të familjes mungojshin, nana m’ka dekë gjatë asaj kohe pak para luftës. Domethonë, mrena familjes i kisha tre të asi... ktu ishte ni katrahurë e vërtetë, gjithësesi. Po masi ishin në tërheqje, se ka zgjatë kjo puna e serbëve në tërheqje, nuk ka qenë aty e preme. Unë kam qenë në Prizren kur i kanë vra ata dy shkije në Prizren, i ka vra, tamon edhe është inçizimi, është xhirimi dhe gjermantë kanë qenë. Ai u kthy *bam, bam, bam* {onomatope}. Dy të vdekur në vend i la. Ata tjetër u mbloodhën edhe ecën.

Ka qenë randë, nuk ka qenë lehtë. Por ai shkatërrimi, djegia karakteristike e lagjeve, e fshatrave e tmerrshme, era. Bashkë me grunë shkumë në Gjakovë, pastaj i ramë anej. Kah kalum kah Krusha i vijke era që i kanë djegë njerëzit edhe i kanë vra, i kanë djeg, kalbësina të ndryshme. Sa njerin, i kanë sakatue. Kta janë... po liria nuk vjen vet, duhet me thirrë edhe përgjakshëm. Ajo nuk vjen vet. S’ka pasë kush me ta pru vet. Unë nuk kisha pasë qef me e provu luftën po erdh. S’kishte qare pa e ba. Nuk kishte qare. Aq edhe është hera e parë që forcat, ni forcë e madhe bashkë me të tjetër të del në ndihmë për me të shpët, se e ka pa.

Në Tiranë e patën hap ni ekspozitë në mujin prill të vitit ‘98-të me fotografitë e të vramëve në Prekaz. Ka pasë pru, ka qenë ni nxanës, ish nxanës i imi, Ilaz Bylykbashi. Ka pasë fotografue në vendin e ngjarjes, ka shku atje ato ditë. Ka pru filmin i kemi ba fotografitë dhe kemi hapë ekspozitë në qendër të Tiranës, mu në qendër. Krejt qendra dy javë s’di sa ka qenë e hapur. 150 fotografi kanë qenë. Me Hamëz, me Adem Jashari, me Shaban Jasharin, me nanën, me gruan, Zade Jasharin, Kushtrimin 14 vjeç. Me gjymtime të ndryshme, katastrofale. Po populli është mbi të gjitha, mbi të gjitha.

Na e kemi për detyrë me mbrojtë, ju e keni për detyrë me mbajtë mend ato çka janë ba, me i shënue në asi dhe m’i shpërnda edhe mundësisht mosha e juj, ma t’ri se ju. Aty jeni, jo mu, se unë jam gërrditë prej ktyne të kqijave. Edhe me pasë qenë, ni jetë tjetër me pasë, nuk kisha zgjedhë tjetër jetë qishtu prapë. Edhe për së dyti me jetu, prapë qishtu.

Anita Susuri: Pas luftës, ju besoj përfundimisht keni ardhë me jetu në Kosovë?

Meriman Braha: Po, përfundimisht. Unë kam qenë pas lufte drejtor i departamentit, kanë qenë nja dhetë-dymdhetë departamente. Kam qenë drejtor i Departamentit të Çështjeve Jorezidente. Ma vonë u bo pjesë e kulturës, Departament i Ministrisë së Kulturës dhe ni kohë, nja pesë-gjashtë vjet kam punu aty. Masnej kam punu zëvendës drejtor i Muzeut të Kosovës dhe kam dalë në pension. Nuk kam, me

vija partiake nuk jam angazhu. Nuk ia kam majt krahun kërkujt, gjithkush e ka bindjen e vet unë e kam timen.

Anita Susuri: Zotëri Meriman, nëse keni me shtu edhe diçka për fund urdhnoni.

Meriman Braha: Unë faleminderit, ju falënderoj për kohën që patët durimin me ndëgjua ni, është variant i shkurtum, shumë i shkurtum. Ka shku 80 vjet në disa minuta, por është detyrë e jona me ju rrëfy juve ma të rive që asgja nuk është në këtë vend me lehtësi, asgja nuk është ba me lehtësi. Në këtë vend çdo gja është ba me shumë sakrifica. Në sakrificat e shumta disa herë, djegiet e shumta disa herë, vrasjet e shumta disa herë, burgosjet e shumta nga serbët e Serbisë. Juve mos ju raftë me pa, ju raftë me dëgju, po mos ju raftë me pa ma ftyrën e tyre kurrë.

Anita Susuri: Faleminderit shumë edhe për kontributin edhe për kohën e ju.

Meriman Braha: Faleminerës, faleminerës.

Anita Susuri: Ishte kënaqësi.